Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

RAPORTI I PUNËS I KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2015

Prill, 2016

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke u bazuar në obligimin e përcaktuar në nenin 63.10 të Ligjit nr. 03/L073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, t`i paraqes Kuvendit të Republikës së Kosovës, Raportin e Punës për vitin 2015.
Ky Raport është, në rend të parë, një pasqyrim i aktiviteteve dhe punës sonë duke përfshirë bashkëpunimin me institucionet e tjera. Raporti i punës i KQZ-së për vitin 2015, është material i treguesve kryesor të KQZ-së. Këta tregues, pasqyrojnë qartësisht hapat në të cilët ne kemi ecur, dhe njëkohësisht shprehin arritjet tona. Gjithashtu, rezultatet pasqyrohen edhe në rubrika dhe ato janë pjesë kronologjike e periudhave të caktuara përgjatë tërë vitit.

Viti 2015, siç dihet, nuk ishte vit zgjedhor në bazë të kalendarit zgjedhor. Mirëpo, KQZ, në fillim të vitit, u ballafaqua me organizimin e Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Komunën e Graçanicës. Zgjedhjet u mbajtën më 18 janar 2015. Ato u organizuan sipas planit dhe me sukses.

Në anën tjetër, vizioni ynë i përcaktuar në dokumentin strategjik të prioriteteve dhe të objektivave të KQZ-së, ka qenë bazë e implementimit të detyrave tona të parapara për vitin 2015. Në këtë raport të punës janë trajtuar çështjet që konsiderohen si shtylla të zhvillimit të brendshëm. Ndërkaq, ky raport, krahas realizimeve dhe arritjeve, pasqyron edhe vështirësitë, duke u fokusuar në çështjet që lidhen me ecurinë e debatit dhe të vendimmarrjes, e që janë gjeneratorë të funksionimit dhe llogaridhënies.

Me Planin Strategjik të miratuar gjatë këtij viti, kemi hedhur themelet e një strukture të qëndrueshme institucionale, si për nga përgatitja profesionale e po ashtu edhe për nga organizimi dhe efikasiteti në realizimin e detyrave. Implementimi i këtij plani përbën boshtin e obligimeve tona kushtetuese dhe ligjore. Duke qenë një institucion i veçantë dhe me mision të qartë, jemi të përkushtuar në realizimin me sukses të objektivave dhe qëllimeve që kemi përpara.
Në fund, mund të konstatojmë se përvoja e deritanishme zgjedhore, forcimi i kapaciteteve tona të brendshme në përmbushjen e veprimtarisë, duke bashkëvepruar edhe me institucionet e brendshme

relevante ashtu si edhe me ato ndërkombëtare, është garanci e profesionalizimit adekuat të institucionit tonë. Ky dimension i profesionalizmit si një nga qëllimet tona substanciale, na mundëson ndërtimin e sigurt të kapaciteteve të duhura zgjedhore, ashtu si edhe plotësimin e sigurt të standardeve ndërkombëtare.

Ndërtimi dhe zbatimi i praktikave të mira zgjedhore, promovimi dhe pjesëmarrja e KQZ-së në ngjarjet ndërkombëtare me karakter zgjedhor, ngritja e transparencës dhe e besueshmërisë, realizimi me integritet i proceseve zgjedhore, rritja e pjesëmarrjes së votuesve në zgjedhje, modernizimi dhe efikasiteti i shërbimeve etj., do të jenë synime të përditshme por edhe strategjike të KQZ-së.

Valdete Daka,
Kryetare e KQZ-së

Lista e shkurtesave

ACEEEO	Asociacioni i Zyrtarëve Zgjedhorë Evropianë
A-WEB	Asociacionit të Trupave Zgjedhore Botërore
BE	Bashkimi Evropian
DPA	Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve
FPR	Formulari i Përputhjes së Rezultateve
FRK	Formulari i Rezultateve të Kandidatëve
IFES	Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KKZ	Komisionet Komunale të Zgjedhjeve
KVV	Këshillat e Vendvotimeve
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
LV	Lista Votuese
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administratës dhe e Pushtetit Lokal
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Integrimeve Evropiane
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OJQ	Organizatat Joqeveritare
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
PZAP	Paneli Zgjedhor për Parashtresa dhe Ankesa
QNR	Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve
QV	Qendra e Votimit
SKQZ	Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
SHV	Shërbimi Votues
VV	Vendvotimet
ZFK	Zarfi i Fletëvotimit me Kusht
ZRPP	Zyra për Regjistrim të Partive Politike

Tabela e përmbajtjes

1 Përmbledhje Ekzekutive ... 8
2 Korniza Ligjore ... 9
3 Përshkrimi i institucionit ... 10
3.1 Misioni ... 10
3.2 Vizioni ... 10
3.3 Kompetencat e KQZ-së sipas ligjit ... 10
4 Fushëveprimi që e mbulon institucioni ... 11
4.1 Mandati i KQZ-së ... 11
4.2 Përgjegjësitë dhe kompetencat ... 11
4.3 Funksionalizimi i KQZ-së ... 12
4.4 Këshillat e KQZ-së ... 12
4.5 Sekretariati i KQZ-së ... 13
4.6 Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim ... 13
4.7 Komisionet komunale të zgjedhjeve ... 13
4.8 Burimet Njerëzore ... 13
4.8.1 Trajnimi i Stafit ... 15
4.9 Asetet e institucionit ... 15
5 Aktivitetet për periudhën raportuese ... 16
5.1 Organizimi i zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar Komune Graçanicë - 2015 .. 16
5.1.1 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe Kandidatëve ... 17
5.1.2 Raportimi Financiar i Fushatës Zgjedhore ... 17
5.1.3 Lista Përfundimtare e Votuesve ... 17
5.1.4 Trajnimi i KKZ-ve dhe KVV-ve ... 19
5.1.5 Dita e Zgjedhjeve ... 19
5.1.6 Numërimi, tabulimi dhe publikimi i rezultateve ... 19
5.2 Aktivitetet sipas Planit të Punës ... 20
5.2.1 Plani Strategjik i KQZ-së për periudhën 2015-2018 ... 20
5.2.2 Grupi punues për qasje zgjedhore ... 21
5.2.3 Rritja e pjesëmarrjes së grave në zgjedhje ... 22
5.2.4 Organizimi i ditës globale të zgjedhjeve ... 22

5.2.5 Projektet 22
5.2.6 Bashkëpunimi me jashtë 23
5.3 Regjistrimi i Partive Politike 25
5.4 Monitorimi i Kuvendeve të Partive Politike 26
5.4.1 Pezullimi i partive politike 27
5.4.2 Çregjistrimi i Partive Politike 28
5.4.3 Takimet e mbajtura me përfaqësuesit e subjekteve politike 28
5.4.4 Azhurnimi vjetor i të dhënave të subjekteve Politike 29
5.4.5 Raportet vjetore të Subjekteve Politike 29
5.4.6 Raportet financiare të SP për Kuvendin e Kosovës 29
5.5 Buxheti dhe Financat 30
5.5.1 Prokurimi 35
5.5.2 Auditimi i brendshëm 36
5.5.3 Mbledhjet dhe vendimet e KQZ-së 37
6 Sfidat dhe rekomandimet 38
6.1 Sfidat 38
6.2 Rekomandimet 38
7 Raportimi rreth adresimit të rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm 40
8 Shtojcat 48

Lista e tabelave

Tabela 1- Struktura kualifikuese e Stafit të SKQZ-së 14
Tabela 2 - Struktura etnike e Stafit të Sekretariatit..... 14
Tabela 3 - Struktura gjinore e Stafit të Sekretariatit 14
Tabela 4- Trajnimet që janë realizuar për ngritjen profesionale të stafit..... 15
Tabela 5- Përmbledhja e pasurive jo-financiare kapitale (me vlerë mbi 1000 Euro) në posedim të KQZ-së..... 15
Tabela 6- Pasuritë jokapitale (me vlerë nën 1000 Euro)..... 16
Tabela 7 - Kandidatët e certifikuar 17
Tabela 8- Rezultatet e certifikuara..... 20
Tabela 9 - Partitë Politike të regjistruara nga KQZ gjate vitit 2015 26
Tabela 10 - Informatat për mbajtjen e Kuvendeve zgjedhore të subjekteve politike 27
Tabela 11 - Lista e Partive Politike të pezulluara, për mos mbajtjen e Kuvendit..... 27
Tabela 12 - Partitë Politike të çregjistruara nga regjistri i partive politike..... 28
Tabela 13- Lista e subjekteve politike të gjobitura nga KQZ-ja për mosdorëzimin e raporteve vjetore 29
Tabela 14- Buxheti i KQZ-së për vitin 2015 32
Tabela 15- Buxheti i planifikuar për Subjektet Politike dhe shpërndarja e mjeteve për vitin 2015 34
Tabela 16 - Buxheti i planifikuar për Grupet Parlamentare dhe shpërndarja e mjeteve për vitin 2015..... 35
Tabela 17 - Raporti i kontratave për vitin 2015..... 36

Lista e Figurave

Figura 1 - Paraqitja grafike e buxhetit te planifikuar dhe shpenzuar..... 33

1 Përmbledhje Ekzekutive

Në pajtim me obligimet që dalin me nenin 63.10 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), paraqet këtë informatë për Raportin e Punës për Kuvendin e Republikës së Kosovës, me qëllim të pasqyrimit të të gjitha aktiviteteve të zhvilluara për periudhën njëvjeçare (2015), duke dëshmuar rolin dhe përgjegjësitë që ka me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Lokale.

Raporti paraqet informacione përmbajtjesore lidhur me progresin e angazhimeve të KQZ-së në arritjen e prioriteteve, objektivave dhe qëllimeve strategjike, si të tilla të përcaktuara me ligjet burimore, Planin Strategjik 2015-2018 dhe Planin Vjetor të Punës 2015. Po ashtu, në raport është bashkangjitur Raporti financiar si dhe veprimet e ndërmarra për gjetjet dhe rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin paraprak.

Meqenëse, në vitin 2015 kishim zgjedhje të jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Graçanicës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, brenda përgjegjësive kushtetuese e ligjore dhe në përputhje me vendimin e Presidentes, ka organizuar dhe administruar këto zgjedhje të mbajtura me 18 janar 2015.

Hartimi i Planit Strategjik 2015-2018, ka qenë objektivi më i rëndësishëm të cilin KQZ e ka përmbushur ne vitin 2015. Në këtë plan, KQZ-ja ka përkufizuar qartazi vizionin dhe misionin e saj, sikurse edhe orientimet strategjike për vitet e ardhshme, përmbushja e të cilave do ta nxjerr KQZ-në si një institucion profesional, me kapacitete dhe përgatitje të mjaftueshme, si dhe transparent, gjithëpërfshirës dhe të paanshëm në procesin e organizimit dhe të administrimit të zgjedhjeve. Duke pasur parasysh qe administrimi i zgjedhjeve si praktikë për nga natyra është proces i cili ndryshon vazhdimisht, KQZ beson se Plani Strategjik, si mjet, do të ndihmojë me synim forcimin e kapaciteteve për të parashikuar dhe për të reaguar ndaj nevojave më cilat do të mund të ballafaqohet në të ardhmen dhe realizimin e përpjekjeve për fuqizimin institucional në aspektin afatgjatë.

KQZ, në kuadër të përgjegjësive të veta ligjore, gjatë vitit 2015 ka arritur t'i realizojë shumicën e objektivave të parapara me Planin e punës. Por, megjithkëtë, ende mbeten sfida që kanë të bëjnë me cilësinë e mbarëvajtjes së proceseve zgjedhore.

2 Korniza Ligjore

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm dhe i pavarur, i përcaktuar me nenin 139 të Kushtetutës se Republikës se Kosovës.

Me qëllim të organizimit të zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike për Kuvendin e Kosovës dhe me qëllim të fuqizimit të qeverisjes demokratike në Kosovë, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Lokale në Republikën e Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Po ashtu, me qëllim të administrimit të zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike për Kuvendet e Komunave dhe Kryetarët e Komunave, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

Me qëllim të rregullimit të mënyrës, kushteve të financimit, administrimit, mbikëqyrjes, transparencës dhe raportimit për shpenzimin e pasurisë dhe të të ardhurave të subjekteve politike në Republikën e Kosovës, Kuvendi ka miratuar Ligjin nr. 04/L-212 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 03/l-174 për Financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/l-058 Ligji për Financimin e Partive.

Me qëllim të operacionalizimit të fushëveprimtarisë së vet, KQZ nxjerr aktet e brendshme nënligjore të cilat sqarojnë dispozitat e ligjit dhe japin më shumë hollësi se si të zbatohen ato në praktikë.

KQZ gjatë këtij viti, ka ndryshuar dhe plotësuar;

a) Rregulloren e Punës, si akt i brendshëm i KQZ-së, që përcakton organizimin dhe mënyrën e funksionimit të tij, duke rregulluar çështjet si në vijim: selinë, vulën dhe simbolet, thirrjen dhe kryesimin e mbledhjeve, përgatitjen e mbledhjeve, kuorumin për punë dhe vendimmarrje, mbajtjen e mbledhjeve, procedurat e vendimmarrjes, konfliktin e interesit, regjistrimin e mbledhjeve, gjuhët që do të përdoren në punën e Komisionit, themelimin e

këshillave të Komisionit dhe kompetencat e tyre, shqyrtimin e parashtresave, transparencën e punës së Komisionit, nxjerrjen e akteve, përfaqësimin e Komisionit, raportin e Komisionit me Sekretariatin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

b) Rregullën Nr 14/2015 mbi Financimin e subjekteve politike dhe sanksionet.

3 Përshkrimi i institucionit

3.1 Misioni

KQZ është përcaktuar të organizojë zgjedhje kredibile dhe me standarde të larta, duke u ofruar të gjithë qytetarëve mundësi dhe shërbime cilësore zgjedhore për ushtrimin e të drejtës së tyre për të zgjedhur dhe për t`u zgjedhur.

3.2 Vizioni

KQZ angazhohet për një institucion të qëndrueshëm, të pavarur dhe inovativ, që forcon demokracinë përmes zgjedhjeve, të cilat gëzojnë besimin e qytetarëve dhe akterëve tjerë.

3.3 Kompetencat e KQZ-së sipas ligjit

Gjatë zbatimit të mandatit të vet KQZ:

a) ndërmerr aktivitete për edukimin e votuesve të përgatitura për ngritjen e vetëdijesimit të votuesit, dhe pjesëmarrjen në zgjedhje;

b) ndërmerr projekte ose kërkime lidhur me sistemin zgjedhor dhe çështjet lidhur me të;

c) krijon procedura të përshtatshme dhe ndërmerr aktivitete për të garantuar se të gjithë personat me aftësi të kufizuara mund ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votimit dhe të marrin pjesë tërësisht në procesin zgjedhor në Kosovë; dhe

d) kryen çdo funksion tjetër ndihmës për mbajtjen e zgjedhjeve në Kosovë që i përcaktohet me Rregulloret relevante dhe instrumentet ndihmëse, përfshirë veprimet e domosdoshme për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor në rast shfaqjeje të një force madhore.

4 Fushëveprimi që e mbulon institucioni

4.1 Mandati i KQZ-së

KQZ-ja është organ i përhershëm i pavarur që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve e referendumet dhe shpall rezultatet e tyre.

4.2 Përgjegjësitë dhe kompetencat

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përcakton në mënyrë të përgjithshme përgjegjësitë dhe funksionet e KQZ-së, ndërsa me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, janë përcaktuar në mënyrë më të specifikuar këto përgjegjësi dhe funksione të KQZ-së. Neni 64 i këtij Ligji, përcakton qartë përgjegjësitë funksionet e KQZ-së, si:

a) Përgatitja dhe shpallja e rregullave, formave dhe procedurave zgjedhore që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji, dhe me çdo çështje tjetër që ka të bëjë me drejtimin e zgjedhjeve në kuadër të kompetencave të veta

b) Publikimi i të gjitha rregullave të miratuara, rregullave, udhëzimeve dhe procedurave zgjedhore duke i bërë ato të arritshme për opinionin.

c) Krijimi dhe mbajtja e Listës së Personave që kanë të dejtë të votojnë në zgjedhje të veçanta.

d) Mbajtja e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikimin e Partive Politike në mënyrën e paraparë me këtë ligj.

e) Përpilimi dhe miratimi i Fletëvotimeve dhe i materialeve të tjera zgjedhore.

f) Akreditimi i Vëzhguesve të zgjedhjeve.

g) Krijimi, mirëmbajtja dhe certifikimi i Listës së Votuese lidhur me zgjedhjet.

h) Numërimi, tabulimi dhe certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve.

i) Regjistrimin dhe certifikimin e subjekteve politike.

4.3 Funksionalizimi i KQZ-së

Përbërja e KQZ-së është e përcaktuar me Kushtetutë. Neni 139, paragrafët 2, 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e rregullojnë saktësisht përbërjen dhe emërimin e kryesuesit të KQZ-së dhe anëtarëve të KQZ-së si në vijim: Komisioni përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë. Kryesuesin e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme apo të Gjykatave me juridiksion apeli. Gjashtë (6) anëtarë të tjerë, emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend. Një (1) anëtar emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara apo të garantuara për komunitetin serb të Kosovës, dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara apo të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë.

Znj.Valdete Daka është emëruar me datë 16 qershor 2010 anëtare dhe kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Anëtarët e KQZ-së, sipas propozimit të Grupeve Parlamentare dhe të partive politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, të cilët janë emëruar nga Presidentja e Kosovës me 16 dhjetor 2014 janë:

1) z.Betim Gjoshi - i nominuar nga Grupi Parlamentar PDK,
2) z.Florian Dushi - i nominuar nga Grupi Parlamentar LDK,
3) z.Adnan Rrustemi - i nominuar nga Lëvizjes Vetëvendosje,
4) z.Binak Vishaj - i nominuar nga Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës,
5) z.Eshref Vishi - i nominuar nga Nisma për Kosovën,
6) z.Ilir Gashi – i nominuar nga Grupi Parlamentar PDK,
7) z.Nenad Rikalo - i nominuar nga Listës Serbe,
8) z.Ercan Spat - i nominuar nga Partia Demokratike Turke të Kosovës,
9) z.Bajram Ljatifi - i nominuar nga Koalicioni VAKAT,
10) z.Ergit Qeli - i nominuar nga Partia Liberale Egjiptiane.

4.4 Këshillat e KQZ-së

Në bazë të Rregullores së Punës, KQZ-ja është organizuar në pesë këshilla të përhershëm. Roli i këshillave është shqyrtimi i çështjeve përkatëse dhe përgatitja e rekomandimeve apo e raporteve për miratim nga KQZ-ja.

1) Këshilli për Operacione Zgjedhore
2) Këshilli për Çështje Ligjore
3) Këshilli për Personel
4) Këshilli për Buxhet dhe Financa
5) Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë
6) Komitetin e Auditimit

4.5 Sekretariati i KQZ-së

Në kryerjen e përgjegjësive dhe funksioneve të tij, KQZ-së i ndihmon Sekretariati, i cili zbaton vendimet e KQZ-së, përgatitë raporte dhe rekomandime për vendime të KQZ-së dhe siguron ndihmë tjetër të nevojshme administrative për KQZ-në.

4.6 Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim

KQZ-ja në pajtueshmëri me ligjin, ka themeluar Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (Zyra e ZRPPC-së). Zyra, është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe azhurnimin e Regjistrit të Partive Politike, për certifikimin e Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre për zgjedhje, kufizimin e shpenzimeve të subjekteve të certifikuara politike gjatë fushatave, si dhe pranimin e Deklarimeve të Financave.

4.7 Komisionet komunale të zgjedhjeve

KKZ-të janë trupa të themeluara nga KQZ-ja në tridhjetë e tetë komunat (38) e Republikës së Kosovës për të ndihmuar në organizimin e zgjedhjeve. Ato janë përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve përbrenda komunave, nën mbikëqyrjen dhe udhëzimet e KQZ-së nëpërmjet Sekretariatit, me qëllim të garantimit të ligjshmërisë, legjitimitetit dhe efikasitetit të procesit zgjedhor.

4.8 Burimet Njerëzore

KQZ ka njëmbëdhjetë (11) anëtarë dhe shtatëdhjetë e shtatë (77) zyrtarë të Sekretariatit të KQZ-së. Nga 77 zyrtarë të Sekretariatit, 38 janë zyrtarë të lartë komunal, përkatësisht nga një zyrtar në secilën komunë të Kosovës.

Struktura kualifikuese		
Fakulteti	**Shkollë e lartë**	**shkollë e mesme**
60	**2**	**10**

Tabela 1- Struktura kualifikuese e Stafit të SKQZ-së

Struktura etnike		
shqiptarë	**serbë**	**turq**
62	**9**	**1**

Tabela 2 - Struktura etnike e Stafit të Sekretariatit

Struktura gjinore	
meshkuj	femra
51	21

Tabela 3 - Struktura gjinore e Stafit të Sekretariatit

Struktura organizative e Sekretariatit është e organizuar në këtë mënyrë,

- Departamenti i Operacioneve Zgjedhore,
- Departamenti i Administratës dhe Përkrahjes,
- Departamenti për Çështje Ligjore,
- Departamenti për Teknologji Informative,
- Drejtori i Auditimit,
- Drejtori i Prokurimit
- Koordinatori i ZLKZ-ve,
- Koordinatori i Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve dhe
- Zyrtari i Lartë Certifikues

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim, funksionon si pjesë e Sekretariatit të KQZ-së, dhe i raporton drejtpërdrejtë KQZ-së.

4.8.1 Trajnimi i Stafit

Një ndër synimet kryesore të KQZ-së është zhvillimi profesional i stafit të Sekretariatit, ku si aktivitet në Planin e Punës për vitin 2015 janë paraparë, planifikuar e realizuar trajnime të vazhdueshme profesionale për stafin, si më poshtë:

	Tema e trajnimit	Numri i pjesëmarrësve	Organizatori i trajnimit
1	Bazat e menaxhimit të projekteve	16	AUK Instituti
2	Sjellja Organizative	2	IKAP
3	Interpretimi i Legjislacionit	4	IKAP
4	Integrime Evropiane	2	IKAP
5	Përafrimi i legjislacionit vendor me atë Evropian	2	IKAP
6	Gjuha angleze	19	Sekretariati i KQZ-së
7	Përfaqësimi gjinor ne trupat menaxhuese të zgjedhjeve	12	OSBE
8	Zhvillimi i politikave publike dhe lidership transformues	7	USAID-AUK

Tabela 4- Trajnimet që janë realizuar për ngritjen profesionale të stafit

4.9 Asetet e institucionit

	2015	2014	2013
Klasifikimi i pasurive	€ '000	€ '000	€ '000
Ndërtesat			
Toka			
Pajisjet			
Infrastruktura			
Makineria			
Automjetet	28	42	55.5
Tjera	101	83	71.5
Gjithsejt	**129**	**125**	**127**

Tabela 5- Përmbledhja e pasurive jo-financiare kapitale (me vlerë mbi 1000 Euro) në posedim të KQZ-së

Përmbledhja e pasurive jokapitale me vlerë nën 1000 Euro dhe me afat të përdorimit më shumë se një vit:

	2015	2014	2013
Klasifikimi i pasurive	**€ '000**	**€ '000**	**€ '000**
Pajisjet dhe mobiljet	232	603	603
	232	**603**	**603**

Tabela 6- Pasuritë jokapitale (me vlerë nën 1000 Euro)

KQZ, pasuritë jo kapitale (me vlerë nën 1000 Euro) i ka të regjistruara në softuerin e-Pasuria. Ky softuer është siguruar nga MAP-i për të gjitha organizatat buxhetore. Në fund të vitit 2015, me këtë program është arritur për herë të parë që të kalkulohet amortizimi në vlerën fillestare dhe sipas viteve për tërë pasurinë e KQZ-së. Kalkulimi i amortizimit ka reflektuar edhe në uljen e vlerës së pasurisë të prezantuar sipas viteve. Në bazë të raportit të Softuerit E-pasuria, pasuria jo kapitale (me vlerë nën 1,000 euro) e KQZ-së për vitin 2015 ka vlerën prej 231,920 euro.

5 Aktivitetet për periudhën raportuese

Më poshtë janë pasqyruar aktivitetet e KQZ-së për periudhën raportuese. Ne fillim paraqiten aktivitetet kryesore në funksion të organizimit dhe administrimit të procesit zgjedhor për kryetar të Komunës së Graçanicës të mbajtur me 18 janar 2015. Në pjesën e dytë paraqiten aktivitetet e KQZ-së, jashtë procesit zgjedhor e të cilat kryesisht janë pjesë e Planit Vjetor të Punës. Më tej paraqiten projektet zhvillimore dhe aktivitetet që ndërlidhen me bashkëpunimin e KQZ-së me jashtë.

5.1 Organizimi i zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar Komune Graçanicë - 2015

KQZ, në kuadër të kompetencave kushtetuese ka ndërmarrë të gjithë hapat ligjor për përgatitjen dhe organizimin e zgjedhjeve të parakohshme për kryetar komune në Graçanicë.

Në bazë të vendimit të KQZ-së për shkurtimin e afateve, Sekretariati ka përpiluar Planin Operacional të Zgjedhjeve, me të cilin janë paraparë të gjitha aktivitetet, afatet ligjore dhe operacionale në funksion të administrimit të procesit zgjedhor.

Me poshtë janë paraqitur aktivitetet dhe detyrat e realizuara që përfshijnë të gjitha aktivitetet që rrjedhin si obligime ligjore, aktivitetet operacionale dhe teknike nga të gjitha njësitë në funksion të organizimit të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar komune në Komunën e Graçanicës.

5.1.1 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe Kandidatëve

KQZ ka certifikuar katër (4) subjekte politike dhe kandidatët për kryetar komune.

Nr	Emri i Subjektit Politik	Lloji i Subjektit Politik	Kandidatët
1.	LDK - LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	Parti Politike	SHAIP BERISHA
2.	PDS - PROGRESIVNA DEMOKRATSKA STRANKA	Parti Politike	NENAD RAŠIĆ
3.	G.I. SRPSKA	Iniciativë qytetare	VLADETA KOSITĆ
4.	NPK - NOVA PARTIJA KOSOVA	Parti Politike	DRAGIŠA MIRIĆ

Tabela 7 - Kandidatët e certifikuar

Më qëllim të vëzhgimit të procesit zgjedhor, KQZ ka akredituar 392 vëzhgues.

5.1.2 Raportimi Financiar i Fushatës Zgjedhore

Afati ligjor për dorëzimin e raporteve të fushatës zgjedhore për zgjedhjet jashtëzakonshme për kryetar komune në Komunën e Graçanicës ishte 4 prill 2015. Për këtë, Zyra ka njoftuar katër subjektet politike, që kanë marrë pjesë në këto zgjedhje, lidhur me afatin ligjor për dorëzimin e Raportit Financiar të Fushatës Zgjedhore, dhe katër subjektet kanë dorëzuar brenda afatit raportin e shpenzimeve të fushatës.

5.1.3 Lista Përfundimtare e Votuesve

Lista Përfundimtare e Votuesve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune në Komunën e Graçanicës është bazuar në Ekstraktin e Regjistrit Qendror Civil.

Krijimi i Listës së votuesve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune në Komunën e Graçanicës ka kaluar nepër dy faza të listës së votuesve:

a) periudha e shërbimit votues, e cila është realizuar nga 29 dhjetor 2014 deri më 10 janar 2015. Përgjatë kësaj periudhe, tre (3) votues kanë kërkuar ndërrimin e qendrave të votimit.

b) periudha e kundërshtimit dhe konfirmimit të Listës së Votuesve, është realizuar nga 8 janar 2015 deri më 10 janar 2015, e cila iu ka mundësuar të gjithë votuesve të komunës së Graçanicës që të sfidojnë LPV-në. Gjatë kësaj periudhe, asnjë votues nuk ka konfirmuar dhe kundërshtuar të dhënat në Listën e Votuesve.

Lista Përfundimtare e Votuesve 2015 për Komunën e Graçanicës ka përmbajtur 20 229 emra të votuesve, me një rritje prej 606 votues apo 3.09% në krahasim me zgjedhjet e fundit për të njëjtën komunë. Votuesit kanë pasur mundësi që të votojnë në dhjetë (10) qendra të votimit në njëzet e shtatë (27) vendvotime.

Votuesit e rinj, që kanë votuar për herë të parë në zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune në Komunën e Graçanicës, kanë qenë 730 votues.

a) 128 votues të rinj që pas zgjedhjeve parlamentare 2014 kanë arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç dhe që kanë pasur mundësi që të votojnë për herë të parë në zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune në Graçanicë më 18 Janar 2015,

b) 602 votues që nuk kanë qenë në Listën Përfundimtare të Votuesve të 2014-tës për Komunën e Graçanicës, e që konsiderohen si votues të regjistruar për herë të parë në Regjistrin Qendror Civil midis dy palë zgjedhjesh.

Programi i Votimit jashtë Kosovës- Periudha e Aplikimit për Regjistrimit është ndërmarrë në mes datës 30 dhjetor 2014 dhe 5 janar 2015. Gjithsej u janë dërguar katërmbëdhjetë (14) aplikacione për regjistrim votuesve që në zgjedhjet e fundit kishin arritur të dëshmonin kriteret e zotësisë juridike për të votuar dhe që i përkasin Komunës së Graçanicës. Informatat e nevojshme dhe formularët për regjistrim janë publikuar në ueb faqen zyrtare të KQZ-së. Gjatë kësaj periudhe, nuk ka pasur asnjë kërkesë për aplikim.

KQZ, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune në Graçanicë, u ka ofruar mundësinë për të votuar të gjithë votuesve, të cilët nuk mund të dalin për të votuar në vendvotimin e zakonshëm për shkak paaftësisë fizike, shëndetësore ose çfarëdo paaftësie tjetër. Periudha e regjistrimit për votuesit me nevoja të veçanta është realizuar deri më 9 janar 2016. Deri me këtë datë kërkesat për regjistrim i kanë parashtruar tre (3) votues, të cilëve në ditën e zgjedhjeve KQZ u ka ofruar mundësinë e votimit përmes ekipeve mobile.

KQZ, nëpërmjet shabllonëve të Braj-it, u ka mundësuar votimin në ditën e zgjedhjeve të gjithë personave të verbër dhe me të pamur të dobësuar .

Përgjatë gjithë këtyre periudhave, KQZ ka ndërmarr aktivitetet e informimit me qëllim të informimit të votuesve për procesin zgjedhor.

5.1.4 Trajnimi i KKZ-ve dhe KVV-ve

Në përputhje me Planin operacional të zgjedhjeve, pas përpilimit dhe përgatitjes së Doracakut të trajnimit, është realizuar programi i trajnimit, i cili është zhvilluar në pesë cikle, duke përfshirë:

1) Trajnimi i trajnerëve të komunës së Graqanicës, lidhur me procedurat e votimit dhe numërimit në vendvotime;
2) Trajnimi i ekipeve mobile për procedurat e votimit të personave me nevoja të veçanta (VPNV-ve);
3) Trajnimi i komisioneve komunale zgjedhore (KKZ-ve) për procedurat e pranim-dorëzimit të materialeve;
4) Trajnimi i këshillave të vendvotimeve (KVV-ve).

Objektiva të trajnimit kanë qenë ngritja e njohurive të stafit të angazhuar në proces zgjedhor në të gjitha nivelet.

5.1.5 Dita e Zgjedhjeve

Bazuar në Planin Operacional për ditën e zgjedhjeve, ekipe mbikëqyrëse nga Sekretariati i KQZ-së**,** kanë mbikëqyrur ecurinë e procesit të votimit. Përmes linjës ndihmëse nga dhoma operative, qytetarët dhe stafi i angazhuar janë ndihmuar dhe këshilluar për çështje që kanë të bëjnë me procedura të votimit në ditën e zgjedhjeve.

5.1.6 Numërimi, tabulimi dhe publikimi i rezultateve

Pas përfundimit të procesit të votimit dhe procesit të numërimit në vendvotim, janë përcjellë të gjitha materialet e ndjeshëm në Qendrën e Numërimit të Rezultateve. Pas pranimit të materialit në QNR, është bërë futja e të dhënave nga formularët e rezultateve të krijuar në vendvotimet e rregullta, votimi me kusht dhe votimi nga jashtë Kosovës. Pas përfundimit të të gjitha procedurave të sipërpërmendura, KQZ ka shpallur rezultatet përfundimtare më 20 janar 2015. Rezultatet përfundimtare janë cerifikuar nga KQZ më 23 janar 2015.

	Kandidatët	Emri i Subjektit Politik	Rezultati	Përqindja
1	VLADETA KOSTIC	G. I SRPSKA	4,784	64,83 %
2	NENAD RAŠIC	PROGRESIVNA DEMOKRATSKA STRANKA	2,325	31,51 %
3	DRAGIŠA MIRIC	NOVA PARTIJA KOSOVA	141	1,91 %
4	SHAIP BERISHA	LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	129	1,75 %

Tabela 8- Rezultatet e certifikuara

5.2 Aktivitetet sipas Planit të Punës

Përveç aktivitetit zgjedhor për zgjedhjet e jashtëzakonshme, KQZ ka zhvilluar aktivitetin e vet edhe në përmbushjen e obligimeve që dalin nga Plani i punë për vitin 2015.

5.2.1 Plani Strategjik i KQZ-së për periudhën 2015-2018

KQZ, më 4 shtator 2015, ka miratuar Planin Strategjik 2015-2018. Gjatë planifikimit të strategjisë, KQZ është përkrahur nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES) me ekspertizë dhe mbështetje logjistike.

Procesi i hartimit të Strategjisë është bazuar në Udhërrëfyesin praktik për Organet e Menaxhimit të Zgjedhjeve për kryerjen e Planifikimit strategjik. Grupi punues i caktuar nga KQZ, përgjatë periudhës një vjeçare ka mbajtur disa takime pune, ku është bërë definimi i bazave të Planit strategjik për të përfunduar si proces me hartimin e draftit final të dokumentit të Planit Strategjik. Grupi punues, pas zhvillimit të draft konceptit të dokumentit e ka përcjellë atë tek akterët e brendshëm dhe të jashtëm për komente dhe rekomandime me qëllim të përfshirjes së tyre në Planin strategjik.

Si pjesë e akterëve të brendshëm, personeli i KQZ-së në zyrat qendrore dhe zyrtarët komunalë janë kontaktuar që të japin e kontributin përmes komenteve dhe rekomandimeve. Dokumenti u është shpërndarë akterëve të brendshëm dhe janë pranuar komente nga 18 zyrtarë, të cilat janë shqyrtuar dhe inkorporuar në Plan.

Gjithashtu, në këtë fazë janë konsultuar edhe akterët e jashtëm, duke konsideruar që përfshirja e akterëve të jashtëm në procesin e hartimit të Strategjisë në mënyrë direkte siguron kontributin e tyre, rritë transparencën e institucionit dhe mundëson zbatim më të suksesshëm.

Si pjesë e konsultimit me akterët e jashtëm, dokumenti u është dërguar për komente të jashtme trembëdhjetë përfaqësive diplomatike, nëntë organizatave joqeveritare dhe dy rrjeteve më të mëdha të organizatave joqeveritare që merren me fushën e zgjedhjeve, pesëmbëdhjetë subjekteve politike parlamentare, tetë institucioneve më cilat KQZ-ja bashkëpunon në mënyrë të drejtpërdrejtë. Gjithsej janë pranuar komente nga dy OJQ, një rrjet i OJQ-ve, një subjekt politik, një institucion dhe dy përfaqësi diplomatike.

Ne mbledhjen e Komisionit nr 23/2015, te datës 4 shtator 2015, është miratuar Plani Strategjik i KQZ-së 2015-2018. Ndërsa më 10 shtator 2015, Komisioni në bashkëpunim me IFES publikuan Planin Strategjik të KQZ-së 2015-2018. Në këtë prezantim morën pjesë përfaqësues të ambasadave të akredituara në Kosovë, subjekteve politike, OJQ-ve, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

5.2.2 Grupi punues për qasje zgjedhore

Me mbështetjen e IFES dhe USAID, është formuar Grupi për Qasje në Zgjedhje, i cili gjatë punës ka pasur mision që të sigurohet një barazi e plotë e personave me aftësi të kufizuara në proceset zgjedhore në jetën publike në përgjithësi. Grupi përbëhet nga deputetë të Kuvendit të Kosovës, anëtarë të KQZ-së, përfaqësues nga PZAP, MPMS, MASHT, Handikos, Shoqata e të Verbërve të Kosovës, Shoqata Kosovare e të Shurdhërve dhe Shoqata Doën Syndrome Kosova. KQZ është bashkëdrejtues i këtij grupi. Grupi ka mbajtur gjithsej 12 takime për vitin raportues. Si rezultat i punës së grupit, në përkrahje të USAID dhe IFES, është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet KQZ-së dhe Shoqatës HANDIKOS, Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, Shoqatës Kosovare të Shurdhërve dhe Shoqatës Doën Syndrome Kosova. Ky Memorandum Bashkëpunimi shpreh përkushtimin e KQZ-së për angazhimin e personave me aftësi të kufizuar në staf zgjedhor gjatë proceseve zgjedhore. Përveç kësaj, grupi ka zhvilluar udhëzuesin për shfrytëzimin e mediave për avokim në fushën e aftësisë së kufizuar, i cili është shpërndarë tek të gjitha organizatat e personave me aftësi të kufizuara.

KQZ, përmes ZLKZ-ve, ka marrë pjesë në projektin për angazhimin e rinisë në procese zgjedhore dhe politike, të implementuar nga organizata joqeveritare Peer Education Netëork, të mbështetur

nga USAID përmes IFES. Konkretisht, KQZ ka kontribuar përmes takimeve me ZLKZ dhe simulimeve të zgjedhjeve, ku ndër të tjera ka siguruar edhe pajisjet për zgjedhje. Takimet me ZLKZ janë mbajtur në komunat: Fushë Kosovë, Malishevë, Istog, Viti, Drenas, Gjilan, Deçan, Ferizaj, Skenderaj, Lipjan dhe Prizren. Ndërsa janë mbajtur simulimet e zgjedhjeve në komunat: Pejë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj dhe Prishtinë.

5.2.3 Rritja e pjesëmarrjes së grave në zgjedhje

KQZ ka marrë pjesë në projektin e IFES të mbështetur nga USAID, me qëllim avokimin për rritjen e numrit të femrave në staf zgjedhor. Janë mbajtur gjithsej 20 takime ne nivel komunal, ku kanë marrë pjesë përfaqësues të OJQ-ve dhe subjekteve politike nga të gjitha komunat e Republikës se Kosovës. Si rezultat është nënshkruar Deklarata e përbashkët e 17 subjekteve politike për rritjen e pjesëmarrjes së grave në staf zgjedhor për proceset e ardhshme zgjedhore.

5.2.4 Organizimi i ditës globale të zgjedhjeve

KQZ ka shënuar “Ditën Globale të Zgjedhjeve”, e cila shënohet që nga viti 2005, në çdo të enjte të parë të muajit shkurt, ndërsa për KQZ-në kjo është hera e tretë e organizimit të kësaj ngjarje edhe në Kosovë.

Në kuadër të shënimit të Ditës Globale të Zgjedhjeve është mbajtur një ligjëratë nga zyrtarët e lartë komunal të zgjedhjeve nga secila komunë për përfaqësuesit e klasave (maturantët), si dhe përfaqësuesit e forumeve rinore nga secila komunë.

Përfaqësuesit e maturantëve dhe të forumeve rinore janë ftuar në sallë kryesisht në hapësira të komunës dhe në shtëpi të kulturës, ku nga ZLKZ-të, është ligjëruar tema: “Rëndësia e pjesëmarrjes së të rinjve në zgjedhje ".

Pas përfundimit të ligjëratës janë shpërndarë fletëpalosje nga ZLKZ-të nëpër secilën komunë.

5.2.5 Projektet

KQZ ka prezantuar tek USAID shtatë (7) projekte të cilat synojnë përmirësimin e funksionimit të brendshëm dhe operacionet e KQZ-së në raport me akterët tjerë. Projektet që kanë gjetur mbështetjen e USAID dhe implementohen nga IFES janë:

a) Sistemi për Menaxhimin e Informatave të Stafit Zgjedhor

Ky sistem është një regjistër elektronik qendror për të gjithë personelin i cili angazhohet në proces zgjedhor. Sistemi digjitalizon procesin e rekrutimit, menaxhimin e resurseve njerëzore dhe mundëson gjenerimin e raporteve të nevojshme për përformancën në punë. Pas zhvillimit, sistemi është testuar nga personeli i KQZ-së për t'u siguruar se ky sistem i plotëson të gjitha kërkesat për menaxhimin e informatave të stafit zgjedhor.

b) Platforma Hartografike e Digjitalizuar për Informatat Zgjedhore

Përmes kësaj Platforme, KQZ mundëson paraqitjen e informatave zgjedhore me theks të veçantë për nivelin e qasjes fizike të personave me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor në Kosovë. Duke bërë paraqitjen e informatave të rëndësishme për procesin zgjedhor në mënyrë interaktive përmes ueb-it kjo platformë ka tri funksione kryesore: Informatat zgjedhore, qasjen për personat me aftësi te kufizuara dhe rezultatet e zgjedhjeve. Platforma është zhvilluar ne sistem hartografik dhe është e qasshme për përdoruesit në internet. Projekti mbetet të përfundojë dhe lansohet në gjysmën e parë të vitit 2016.

5.2.6 Bashkëpunimi me jashtë

5.2.6.1 Takimet me Departamentin e Zgjedhjeve të Organizatës së Shteteve Amerikane

Një delegacion i KQZ-së, i përbërë nga pesë anëtarë kanë qëndruar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Uashington) ku zhvilluan disa takime. Delegacioni u takua me drejtues të Departamentit të Zgjedhjeve të Organizatës së Shteteve Amerikane (OAS), të cilët prezantuan angazhimin e kësaj organizate në shtetet anëtare, në fushën e zgjedhjeve, dhe me theks të veçantë në çështjet e përmbushjes së standardeve të cilësisë ISO të aktiviteteve të të gjitha fazave zgjedhore. Gjatë qëndrimit në Uashington, delegacioni i KQZ-së u takua edhe me drejtuesit e IFES-it dhe NDI ku u diskutuan çështjet zgjedhore në Kosovë dhe format e bashkëpunimit e përkrahjes në të ardhmen.

5.2.6.2 Pjesëmarrja në seminare, konferenca dhe aktivitete trajnuese

Me ftesë të Ambasadës së Republikës së Sllovenisë në Tiranë, KQZ-ja u përfaqësua në seminarin dy ditor më 2 dhe 3 mars, me temën Forcimi i pavarësisë së organeve zgjedhore, në Tiranë, Ky

seminar është organizuar nga Qendra për Perspektivë Evropiane (CEP) në kuadër të Bashkëpunimit për Zhvillim Ndërkombëtar të Republikës së Sllovenisë.

KQZ i është bashkuar rreth 60 institucioneve nga vende të ndryshme të botës, të cilat merren me organizimin e zgjedhjeve, në Konferencën e 12-të më radhë të Trupave Menaxhuese Zgjedhore që është mbajtur në Bruksel. "Sigurimi i neutralitetit, paanshmërisë dhe transparencës në zgjedhje: roli i Trupave Menaxhuese Zgjedhore", ishte tema qendrore e kësaj konference e bashkëorganizuar nga Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës dhe Ministrisë së Brendshme të Belgjikës (Njësia e Zgjedhjeve).

Me ftesë të Asociacionit të Trupave Zgjedhore Botërore (A-WEB) një delegacion i KQZ-së, prej dy anëtarëve ka qëndruar në Republikën Domenikane, ku kanë marrë pjesë në Konferencën e Dytë Botërore (18-21 gusht) të Asamblesë së Përgjithshme të këtij asociacioni.

Në këtë Konferencë përfaqësuesit e institucioneve që merren me administrimin e zgjedhjeve nga 94 shtete anëtare të A-WEB, kanë diskutuar dhe shkëmbyer përvojat në lidhje me "Rolin dhe Sfidat e Trupave Zgjedhore për të Garantuar Integritetin e Zgjedhjeve", e që ishte edhe tema kryesore e kësaj ngjarjeje.

KQZ mori pjesë në seminarin e mbajtur në Tiranë me temën: "Forcimi i pavarësisë së Trupave të Menaxhimit Zgjedhor - Shkëmbimi i përvojave dhe mësimet e nxjerra mes Shqipërisë dhe Sllovenisë". Ky seminar u organizua më 5 tetor në kuadër të projektit të Qendrës për Perspektivë Evropiane, i mbështetur nga Departamenti për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Sllovenisë.

Konferenca kishte si qëllim ofrimin e mundësive për partitë politike dhe organet zgjedhore për shkëmbimin e eksperiencave të tyre. Gjatë konferencës u prezantua një përmbledhje e raporteve të fundit të vëzhguesve për zgjedhjet e fundit dhe diskutimet e të pranishmëve u fokusuan në rolin e partive politike në zgjedhje dhe dialogu mes partive politike me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në Programin e Dytë Për Vizitorët Zgjedhor në Republikën e Kirgizisë të mbajtur nga 1 deri më 7 tetor, në ndërlidhje me Zgjedhjet Parlamentare të mbajtura në Republikën Kirgize, KQZ u përfaqësua në mesin e tridhjetë e tetë (38) ekspertëve zgjedhor nga 27 vende të cilët u mblodhën

për të vëzhguar dhe analizuar efektivitetin e Teknologjisë së Informacionit në zgjedhje që është prezantuar për herë të parë në vend.

5.2.6.3 Vëzhgimi i zgjedhjeve

KQZ qëndroi në Shqipëri për të vëzhguar procesin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore që u mbajtën më 21 qershor. Një ditë para ditës së zgjedhjeve, delegacioni i KQZ-së, në përbërje prej gjashtë (6) anëtarëve janë pritur në takim nga kryetarja znj. Lefterije Luzi dhe anëtarët e KQZ-së të Shqipërisë. Në ditën e zgjedhjeve anëtarët e KQZ-së ishin prezent në disa qendra të votimit për të përcjellë nga afër organizimin e zgjedhjeve dhe procesin e numërimit të votave. KQZ ka vëzhguar procesin e zgjedhjeve në Bullgari dhe Poloni që u zhvillua më 25 tetor 2015. Delegacioni i KQZ-së, në përbërje gjashtë (6) anëtarëve kanë qëndruar në Bullgari ku u pritën nga kryetarja e KQZ-së së Bullgarisë, znj. Ivilina Aleksieva dhe anëtarët e këtij Komisioni.

Një delegacion tjetër i KQZ-së, në përbërje të katër (4) anëtarëve kanë qëndruar në Poloni me ftesë të Komisionit Nacional Zgjedhor për të vëzhguar zgjedhjet parlamentare në Poloni, Delegacioni i KQZ-së së bashku me delegacionet nga Lituania, Letonia, Rumania dhe Tajlanda, janë pritur në takim të përbashkët nga kryetari i Komisionit Nacional Zgjedhor të Polonisë, z. Wojciech Hermelinski. Gjatë ditës së zgjedhjeve, anëtarët e KQZ-së ishin prezent në disa qendra votimit për të parë nga afër përgatitjet, procesin e votimit si dhe procesin e numërimit të votave.

5.2.6.4 Vizita e KQZ-së se Shqipërisë në Kosovë

Një delegacion i KQZ-së së Republikës së Shqipërisë, i kryesuar nga kryetarja e këtij institucioni, znj. Lefterije Luzi, në dhjetor 2015 qëndroi për vizitë ne KQZ. Gjatë këtij takimi u diskutua për mbështetjen e ndërsjelltë ndërmjet dy institucioneve dhe nevojën e avancimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ndër-institucional.

5.3 Regjistrimi i Partive Politike

Në pajtim me nenin 12 të Ligjit nr. 03/l-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregullën nr 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, gjatë vitit 2015 janë regjistruar dy (2) Parti Politike.

Akronimi	Emri i Partisë politike	Data e regjistrimit
	FJALA	12 qershor 2015
OBKD	ORGANIZATA BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT	21 dhjetor 2015

Tabela 9 - Partitë Politike të regjistruara nga KQZ gjate vitit 2015

Të gjitha Partitë Politike e kanë respektuar afatin ligjor, për dorëzimin e formularit për vazhdimin e regjistrimit deri më datën 31 mars 2015.

5.4 Monitorimi i Kuvendeve të Partive Politike

Në periudhën janar - dhjetor 2015, janë monitoruar nëntëmbëdhjetë (19) kuvende zgjedhore të partive politike, të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

	Akronimi	Emri i Partisë	Data e mbajtjes së Kuvendit
1	**PNDSH**	PARTIA NACIONALE DEMOKRATIKE SHQIPTARE	25.04.2015
2	**DSB**	DEMOKRATSKA STRANKA BOŠNJAKA	16.05.2015
3	**LQV**	LËVIZJA QYTETARE VATRA	10.05.2015
4	**DSV**	DEMOKRATSKA STRANKA VATAN	16.05.2015
5	**LDK**	LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	31.05.2015
6	**PD**	PARTIA E DREJTËSISË	07.06.2015
7	**PREBK**	PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS	07.06.2015
8	**PDU**	PARTIA DEMOKRATIKE E UNITETIT	11.06.2015
9	**BKK**	BALLI KOMBËTAR I KOSOVËS	20.06.2015
10	**KDTP**	KOSOVA DEMOKRATIK TÜRK PARTISI	26.06.2015
11	**REK**	REPUBLIKANËT E KOSOVËS	27.06.2015
12	**AAK**	ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS	02.07.2015
13	**PG**	POKRET ZA GORA	10.07.2015

14		FJALA	13.09.2015
15	**PDKI**	PARTIA DEMOKRATIKE PËR INTEGRIM	31.10.2015
16	**LB**	LËVIZJA PËR BASHKIM	14.112015
17	**NPK**	NOVA PARTIJA KOSOVA	29.11.2015
18	**PGJK**	PARTIA E TË GJELBËRVE TË KOSOBËS	29.11.2015
19	**SNSD**	SAVEZ NEZAVISNIH SOCIJALDEMOKRATA	28.12.2015

Tabela 10 - Informatat për mbajtjen e Kuvendeve zgjedhore të subjekteve politike

5.4.1 Pezullimi i partive politike

KQZ-ja ka pezulluar dymbëdhjetë (12) Parti Politike nga regjistri i partive të regjistruara, për mos mbajtjen e Kuvendit, në pajtim me nenin 15.1 të Rregullës nr. 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.

Nr.	Akronimi	Emri i Partisë
1	DA	DEMOKRATSKA ALTERNATIVA
2	LDD	LIDHJA DEMOKRATIKE E DARDANISË
3	ND	NOVA DEMOKRATIJA
4	PDI	PARTIJA DEMOKRATSKE INTEGRACIJE
5	PGJK	PARTIA E TË GJELBËRVE TË KOSOVËS
6	PPK	PARTIA E PENSIONISTËVE TË KOSOVËS
7	SDP	STRANKA DEMOKRATSKIH PROMJENA
8	S.SDS	SRPSKA SOCIJALDEMOKRATSKA STRANKA
9	LB	LËVIZJA PËR BASHKIM
10	PDKI	PARTIA DEMOKRISTIANE PËR INTEGRIM
11	SDS	SAMOSTALNA DEMOKRATSKA STRANKA
12	SNS	SRPSKA NARODNA STRANKA

Tabela 11 - Lista e Partive Politike të pezulluara, për mos mbajtjen e Kuvendit.

5.4.2 Çregjistrimi i Partive Politike

KQZ, duke u bazuar në nenin 8 pika 8.1 e) e Rregullës 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, çregjistroi nga Regjistri i partive politike dhjetë (10) Parti Politike të pezulluara sipas dispozitave të nenit 6 të kësaj Rregulle, të cilat nuk kanë vepruar sipas afatit të shtuar prej dyzet e pesë (45) ditësh. Ndërsa tri (3) parti politike të cilat kanë mbajtur kuvendet e tyre zgjedhore, me vendim të KQZ-së, janë kthyer në Regjistrin e partive politike.

Nr.	Akronimi	Partia Politike
1	DA	DEMOKRATSKA ALTERNATIVA
2	LDD	LIDHJA DEMOKRATIKE E DARDANISË
3	ND	NOVA DEMOKRATIJA
4	PDI	PARTIJA DEMOKRATSKE INTEGRACIJE
5	PPK	PARTIA E PENSIONISTËVE TË KOSOVËS
6	SDP	STRANKA DEMOKRATSKIH PROMJENA
7	S.SDS	SRPSKA SOCIJALDEMOKRATSKA STRANKA
8	SDS	SAMOSTALNA DEMOKRATSKA STRANKA
9	SNS	SRPSKA NARODNA STRANKA
10	KTB	KOSOVA TURK BIRLIGI

Tabela 12 - Partitë Politike të çregjistruara nga regjistri i partive politike

5.4.3 Takimet e mbajtura me përfaqësuesit e subjekteve politike

Sipas nenit 40.7 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Zyra për Regjistrimin e Partive Politike, ka organizuar trajnim me përfaqësuesit financiar të subjekteve politike.

Gjithashtu, është mbajtur takimi i cili ka pasur për qëllim të njoftoj përfaqësuesit e subjekteve politike me ndryshim plotësimin e Rregullës nr. 14/2015 mbi Financimin e Subjekteve Politike dhe Sanksionet.

5.4.4 Azhurnimi vjetor i të dhënave të subjekteve Politike

Gjashtëdhjetë e shtatë (67) parti politike brenda afatit ligjor janë dorëzuar në KQZ të dhënat e azhurnuara të subjekteve politike.

5.4.5 Raportet vjetore të Subjekteve Politike

Në pajtim me obligimet që dalin nga neni 15 i Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike dhe nenit 7 të Rregullës Zgjedhore nr. 14/2015 mbi Financimin e Subjekteve Politike dhe Sanksionet, për vitin paraprak nuk kanë dorëzuar raportet vjetore financiare dymbdhjetë (12) parti politike, e të ciilave KQZ u ka shqiptuar gjoba, të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Nr	Emri i subjektit politik	Lloji i Subjektit politik	Përfaqësuar në Kuvend	Gjoba bazë
1	Demokracia Sociale e Kosovës	Parti politike	JO	1,000 €
2	Partia e Pensionisteve të Kosovës	Parti politike	JO	1,000 €
3	Lëvizja Islame Bashkohu	Parti politike	JO	1,000 €
4	Partia Nacionale Demokratike Shqiptare	Parti politike	JO	1,000 €
5	Narodna Crnogorska Partija Kosova	Parti politike	JO	1,000 €
6	Samostalna Demokratska Stranka	Parti politike	JO	1,000 €
7	Socijaldemokratija	Parti politike	JO	1,000 €
8	Nova Partija Kosova	Parti politike	JO	1,000 €
9	Srpska Narodna Stranka	Parti politike	JO	1,000 €
10	Srpska Narodna Partija Kosova	Parti politike	JO	1,000 €
11	Nova Demokratija	Parti politike	JO	1,000 €
12	Demokratska Alternativa	Parti politike	JO	1,000 €
	Totali			12,000 €

Tabela 13- Lista e subjekteve politike të gjobitura nga KQZ-ja për mosdorëzimin e raporteve vjetore

5.4.6 Raportet financiare të SP për Kuvendin e Kosovës

KQZ në pajtim me Ligjin nr. 04/L 058, ka përgatitur Raportin vjetor financiar te Fondit për mbështetje të subjekteve politike për vitin 2014 dhe e ka dërguar ne Kuvendin e Kosovës .

5.5 Buxheti dhe Financat

KQZ është organizatë buxhetore me kod organizativ 320 dhe me tri programe:

14100 Sekretariati

14200 Zgjedhjet dhe

10400 Mbështetje Partive politike

i. Aprovimi i buxhetit

Me Ligjin për Buxhetit të Kosovës nr. 05/L-001 për vitin 2015, KQZ-së i është aprovuar Buxheti për të tri programet në shumë prej 5,329,718 euro dhe numri i aprovuar i stafit ishte 88 zyrtarë.

Struktura e buxhetit të aprovuar për vitin 2015 ishte kështu:

- Paga dhe mëditje 708,023 euro
- Mallra dhe shërbime 374,904 euro
- Shpenzime komunale 46,791 euro
- Subvencione 4,200,00 euro

ii. Buxheti shtesë

Qeveria me vendimin numër 05/06 të datës 10 janar 2015 për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme në komunën e Graçanicës, KQZ-së i ka ndarë buxhet shtesë në shumë prej 181,817 euro. Buxheti shtesë sipas kategorive:

- Paga dhe mëditje 27,152 euro
- Mallra dhe shërbime 153,065 euro dhe
- Shpenzime komunale 1,600 euro.

Buxheti shtesë ka ndikuar në rritjen e Buxhetit të KQZ-së nga 5,329,718 euro sa ishte i aprovuar, në 5,511,535 euro. Pas aprovimit të buxhetit shtesë në janar, sipas kategorive ekonomike, buxheti i KQZ-së duket kështu

- Paga dhe mëditje 735,175 euro
- Mallra dhe shërbime 527,969 euro
- Shpenzime komunale 48,391 euro
- Subvencione 4,200,000 euro

iii. Rishikimi i Buxhetit

Me ligjin nr. 05/L -046 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, buxheti i KQZ-së është shkurtuar në paga dhe mëditje dhe në mallra dhe shërbime. Buxheti në total është shkurtuar për 142,936 euro, përkatësisht në paga dhe mëditje buxheti është shkurtuar për 51,236 euro dhe tani në këtë kategori buxheti është 683,939 euro. Në mallra dhe shërbime, në programin e Sekretariatit, buxheti u shkurtua për 42,927 euro, ndërsa në programin e zgjedhjeve për 48,773 euro. Në total në mallra dhe shërbime buxheti u shkurtua për 91,700 euro. Pas rishikimit, buxheti i KQZ-së kishte vlerën në shumë prej 5,368,599 euro. Sipas kategorive ekonomike KQZ kishte këtë buxhet:

- Paga dhe mëditje 683,939 euro
- Mallra dhe shërbime 436,269 euro
- Shpenzime komunale 48,391 euro
- Subvencione 4,200,000 euro

iv. Buxheti i KQZ-së pas vendimeve të Qeverisë

Përveç rishikimit të buxhetit të vitit 2015, me vendimin e Qeverisë nr.09/65, KQZ-së i bëhen shkurtime buxhetore në kategorinë mallra dhe shërbime në programin e Sekretariatit në shumën 58,966 euro dhe në programin e Zgjedhjeve 47,934 euro. Gjithsej KQZ-së në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve buxheti i shkurtohet për 106,900 euro. Me të njëjtin vendim të cekur më lart janë bërë shkurtime të buxhetit edhe në kategorinë e shpenzimeve komunale. Buxheti i Sekretariatit në këtë kategori u shkurtua për 10,773 euro ndërkaq buxheti i Zgjedhjeve u shkurtua për 8,102 euro. Në total buxheti i KQZ-së në shpenzime komunale u shkurtua për 18,875 euro. Me vendimin e Qeverisë nr 12/64, për mbulimin e minusit në paga dhe mëditje për muajin dhjetor 2015, Ministria e Financave i ka ndarë KQZ-së mjete në shumë prej 30,861 euro.

v. Buxheti final

Në fund të vitit 2015 sipas kategorive ekonomike, KQZ kishte këtë buxhet:

- Paga dhe mëditje 714,800 euro
- Mallra dhe shërbime 329,369 euro
- Shpenzime komunale 29,516 euro
- Subvencione 4,198,956 euro

Pra vlera totale e buxhetit të KQZ-së në fund të vitit 2015 ishte në vlerë prej 5,272,642.74 euro. Shuma e buxhetit të shpenzuar është 5,228,118.85 euro apo shprehur në përqindje buxheti u shpenzua 99.1%.

Kategoritë ekonomike	Buxheti fillestar	Buxheti final	Buxheti shpenzuar	% Buxheti i shpenzuar
	A	C	D	E=D/A*100
Paga dhe Mëditje	708,023	714,800	714,800	100.00%
Mallra &Shërbime	374,904	329,369	285,133	86.57%
Shpenzimet Komunale	46,791	29,516	29,512	99.98%
Subvencione dhe transfere	4,200,000	4,198,955	4,198,673	99.99%
Shpenzimet Kapitale	-	-	-	0.00%
Totali	5,329,718.	5,272,643	5,228,119	99.16%

Tabela 14- Buxheti i KQZ-së për vitin 2015

Buxheti i planifikuar i KQZ-se për vitin 2015 ne shume prej 5,329,718.00 € ka këtë strukturë buxhetore:

- 14 % të fondeve janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe mëditje;
- 5 % të fondeve është akorduar për shpenzime mallra dhe shërbime;
- 80 % te fondeve për subvencione dhe transfere;
- 1 % për shpenzimet komunale;
- 0 % të fondit për shpenzime kapitale, nuk ka planifikime ne këtë kategori.

Në vitin 2015, KQZ ka shpenzuar 5,228,118.85 euro të buxhetit të planifikuar, përkatësisht buxheti i planifikuar është shpenzuar 99.16%.

Shprehur në përqindje, sipas kategorive ekonomike KQZ ka shpenzuar buxhetin me këtë strukturë: ne kategorinë e pagave dhe mëditjeve buxheti i planifikuar u shpenzua 100.00%, në mallra dhe shpenzime buxheti u shpenzua 86.57%, shpenzimet komunale u shpenzuan 99.98%, shpenzimet subvencione dhe transfere buxheti u shpenzua 99.99% dhe buxheti për shpenzime kapitale u shpenzua 0.00% (nuk ka pasur buxhet të alokuar në këtë kategori).



Figura 1 - Paraqitja grafike e buxhetit te planifikuar dhe shpenzuar

vi. Subvencione dhe transfere

Me Ligjin nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës se Kosovës për vitin 2015 buxheti i aprovuar për programin Mbështetje e Subjekteve Politike(10400) ishte në shume prej 4,200,000 euro.

Me rishikim te buxhetit Qeveria ne kategorinë e Subvencioneve dhe transfereve e ka zvogëluar buxhetin 1,044.06 euro

Pas ndryshimeve të bëra të buxhetit me vendim të qeverisë buxheti final ishte në shumë prej 4,198,955.94 euro. Subjektet politike gjatë vitit 2015nga buxheti subvencioneve kanë shpenzuar buxhetin ne shumë prej 4,198,673 euro apo buxhetin e kanë shpenzuar 99.99%.

Nr.	Kodi Programit	Subjekte Politike	Nr. Vendeve mandati i ri	Planifikimi i buxhetit	Shuma e paguar	% e realizimit
1	10402	PDK	37	1,165,500.00	1,165,500.00	100.00%
2	10401	LDK	30	945,000.00	945,000.00	100.00%
3	10427	VETVENDOSJE	16	504,000.00	504,000.00	100.00%

4	10403	AAK	11	346,500.00	346,500.00	100.00%
5	10432	SRPSKA LISTA	9	283,500.00	283,500.00	100.00%
6	10433	NISMA	6	189,000.00	189,000.00	100.00%
7	10407	KDTP	2	63,000.00	63,000.00	100.00%
8	10406	VAKAT	2	63,000.00	63,000.00	100.00%
9	10416	PDAK	1	31,500.00	31,500.00	100.00%
10	10430	PAI	1	31,500.00	31,500.00	100.00%
11	10431	NDS	1	31,500.00	31,500.00	100.00%
12	10434	PDS	1	31,500.00	31,500.00	100.00%
13	10435	PLE	1	31,500.00	31,500.00	100.00%
14	10436	KZAG	1	31,500.00	31,500.00	100.00%
15	10437	KNRP	1	31,500.00	31,500.00	100.00%
Totalet			**120**	**3,780,000.00**	**3,780,000.00**	**100.00%**

Tabela 15- Buxheti i planifikuar për Subjektet Politike dhe shpërndarja e mjeteve për vitin 2015

Nr.	Kodi Programit	Grupi Parlamentar	Nr. Vendeve mandati i ri	Planifikimi i buxhetit	Shuma e paguar	% e realizimit
1	10452	PDK	37	129,500.00	129,342.37	99.88%
2	10451	LDK	30	105,000.00	104,864.42	99.87%
3	10462	VETVENDOSJE	16	56,000.00	55,241.14	98.64 -
4	10453	AAK	11	38,500.00	38,430.76	99.82%
5	10461	6+	6	21,000.00	20,807.10	99.08%
6	10464	SRPSKA LISTA	9	31,500.00	31,494.60	99.98%
7	10465	NISMA	6	21,000.00	20,995.49	99.98%

8	10475	PDS	1	3,500.00	3,500.00	100.00%
9	10476	PAI	1	3,500.00	3,500.00	100.00%
10	10477	NDS	1	3,500.00	3,500.00	100.00%
11	10472	PLE	1	3,500.00	3,500.00	100.00%
12	10478	KZA	1	3,500.00	3,497.31	99.92%
Totali			**120**	**420,000.00**	**418,673.19**	**99.68%**

Tabela 16 - Buxheti i planifikuar për Grupet Parlamentare dhe shpërndarja e mjeteve për vitin 2015

5.5.1 Prokurimi

Plani i prokurimit për vitin 2015 është përgatitur dhe është dorëzuar në Autoritetin Qendror të Prokurimit. Ky plan është përgatitur në bazë të rrjedhës së parasë dhe kërkesave të njësive kërkuese. Qëllimi i dorëzimit të Planit final në AQP është që të ofrohen informacione të plota për prokurimet e planifikuara, në mënyrë që AQP-ja të identifikoj artikujt e përdorimit të zakonshëm të cilët mund të blihen në mënyre më efikase përmes aplikimit të procedurës së përbashkët apo të konsoliduar të prokurimit ose përmes përdorimit të kontratave qendrore kornizë.

Ne vijim janë paraqitur aktivitetet e prokurimit ne mënyrë tabelore:

Nr.	Aktivitet e prokurimit	Data e nënshkrimit te kontratës	Vlera e parashikuar e kontratës	Çmimi i kontratës
1	Sigurimi kasko i automjeteve	29.01.2015	7,000.00 €	5,766.74 €
2	Shërbime postare për proces zgjedhor	05.01.2015	5,000.00 €	3,400.00 €
3	Asgjësimi i materialit te zgjedhor te jashtëzakonshme ne Graçanicë	28.03.2015	300 €	150.00 €
4	Furnizimi me ujë te pijes	05.06.2015	deri ne shumen e shpenzuar 9,900.00€	totali i çmimeve te njësive 2,68€
5	Furnizimi me aparate te telefonisë fikse	05.11.2015	6,800 €	6,800.00€

6	Shtypja e ligjeve, rregullave dhe planit strategjik	29.12.2015	9,800.00 €	2,575.00€
7	Furnizimi me klima	15.12.2015	2,000.00 €	1,800.00€
8	Mirëmbajtja dhe higjena e objekti	07.10.2014	10,000.00 € vjetore	kohezgjatja 07.10.2016 mujore(384.62)
9	Servisimi i T.I	11.11.2013	12,000.00 € vjetore	kohëzgjatja 11.11.2016 totali i çmimeve te njësive 9,480.00€
10	Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve	25.11.2013	11,000.00 € vjetore	kohëzgjatja 25.11.2015 totali i çmimeve për njësi 39.078€
10	Furnizim me material Zyrtar	07.07.2014	30,000.00 € vjetore	kohëzgjatja 07.07.2017 totali i çmimeve të dhëna për njësi 65,71€
11	Shërbimet e Interneti	28.04.2014	15,000.00 € vjetore	kohëzgjatja 28.04.2017 mujore 524.00€
12	Furnizim me Derivate	21.11.2014	20,000.00 € vjetore	kohëzgjatja 14.09.2017 0,0260€ premium për litër për automjete dhe 0,0199 premium për litër për gjenerator

Tabela 17 - Raporti i kontratave për vitin 2015

5.5.2 Auditimi i brendshëm

Bazuar në Planin vjetor të Auditimit janë realizuar pesë (5) aktivitete audituese, të paraqitura si më poshtë :

1.Auditimi i DAP-it, mars 2015-	6 rekomandime;
2.Auditimi i DTI-së, qershor 2015-	4 rekomandime;
3.Auditimi i prokurimit, shtator 2015-	3 rekomandime dhe
4.Auditimi i DAP-it II Tetor 2015-	7 rekomandime;
5.Auditimi i prokurimit II, dhjetor 2015-	7 rekomandime;

5.5.3 Mbledhjet dhe vendimet e KQZ-së

Gjatë vitit raportues, KQZ ka mbajtur 33 mbledhje, ku janë nxjerr 146 vendime ndërsa ka dërguar 3 rekomandime Zyrës së Presidentit.

KQZ ka zëvendësuar 41 anëtar të kuvendeve komunale. Arsyet e këtyre zëvendësimeve mund të kategorizohen si: për shkak të dorëheqjes, mungesat ne mbledhje te kuvendeve komunale, konflikt interesi me ligjin për shërbimin civil, marrje e pozitës ne shërbimin civil brenda kuvendit komunal.

6 Sfidat dhe rekomandimet

6.1 Sfidat

Gjatë realizimit të aktiviteteve për vitin raportues, KQZ ka hasur në sfida, efekti i të cilave ndikon negativisht në realizimin e aktiviteteve:

1. Mos integrimi i sistemit unik të adresave në Regjistrin Qendror Civil ndikon në krijimin e Listës Votuese jo të saktë.
2. Objektet qe shërbejnë si qendra të votimit përgjithësisht nuk janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara.
3. Mosauditimi i Raporteve Financiare të Subjekteve Politike.
4. Mos trajtimi i barabartë i stafit të Sekretariatit të KQZ-së në raport me institucionet tjera të pavarura kushtetuese, në paga dhe kjo ndikon ne cenimin e pavarësisë se institucionit dhe mos qëndrueshmërinë e stafit në institucion.
5. Mungesë e hapësirës se mjaftueshme për punë dhe aktivitet zgjedhor për stafin e KQZ-së.
6. Mungesa e mbështetjes së mjaftueshme në disa komuna për zyrtarët e Lartë Komunal të Zgjedhjeve .
7. Objekti të cilin KQZ e shfrytëzon si Qendër e Numërimit dhe Rezultateve është objekt i kontestit civil, pranë Gjykatës themelore në Prishtine dhe ekziston rreziku që në të ardhmen ky objekt t'i dorëzohet në pronësi të personave tjerë.

6.2 Rekomandimet

Me qëllim të tejkalimit të sfidave dhe të vështirësive të lartpërmendura, në përpjekje për të ndërtuar një institucion profesional dhe të qëndrueshëm të administrimit të zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, rekomandon:

1. Integrimi i sistemit unik të adresave në Regjistrin Qendror Civil.
2. Te krijohet qasja në objektet që shërbejnë si qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara.
3. Të bëhet auditimi i Raporteve Financiare të Subjekteve Politike.
4. Trajtim meritor i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe personelin e tij që është i specializuar në fushën e organizimit të zgjedhjeve, sikurse institucionet e tjera të cilat kanë bazë të njëjtë kushtetuese.

5. Caktimi i një objekti të përhershëm dhe me hapësirë të mjaftueshme për punë për KQZ-në.

6. Ofrimi i mbështetjes nga disa komuna për zyrtarët komunal të zgjedhjeve.

7. Futja ne Ligj e detyrimit për komunat në mënyrë që t'i përkrahin KKZ-të.

8. Definimi i qartë i të drejtës së votës për votuesit dhe të përcaktohet vetëm për qytetarët e Republikës së Kosovës të regjistruar në Regjistrin Civil, dhe të pajisur me dokumente të Republikës së Kosovës. Kjo nënkupton që personave të cilët nuk janë të regjistruar në Regjistrin Qendror Civil, të mos u lejohet pjesëmarrja në votime dhe vlerësimi i këtyre kritereve të mos jetë në kompetencë të KQZ-së.

9. Lehtësimi i mënyrës së votimit jashtë vendit, duke iu dhënë hapësirë më madhe për pjesëmarrje të gjithë qytetarëve të Kosovës që jetojnë jashtë vendit.

10. Të gjenden mekanizmat për t'i identifikuar qytetarët e Republikës së Kosovës që jetojnë jashtë vendit, dhe kanë të drejtë vote si dhe shënimin e tyre në Regjistër Civil dhe në Listën e Votuesve.

11. Heqjen e votimit me kusht dhe angazhimi i institucioneve relevante shtetërore për të përmirësuar të dhënat mbi qytetarët me të drejtë vote në Regjistër Civil, si bazë për krijimin e një liste të votuesve të saktë dhe të qëndrueshme.

12. Definimi i qartë i dokumenteve të identifikimit të votuesve gjatë procesit të votimit, duke caktuar vetëm dokumentet shtetërore të Republikës së Kosovës, kuptohet, si dokumente të vlefshme për identifikim.

7 Raportimi rreth adresimit të rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm

Sa i përket shqyrtimit të implementimit të rekomandimeve të zyrës së auditorit, si e tillë ndahet në tre faza të rekomandimeve.

- Faza e parë shqyrtimit dhe implementimit të rekomandimeve të zyrës së auditorit gjeneral për vitin 2014 ka përfunduar me datën 30 shtator 2015.
- Faza e dytë e shqyrtimit implementimit të rekomandimeve të zyrës së auditorit gjeneral për vitin 2014, ku si fazë, ende është në procesin e shqyrtimeve, dhe
- Faza e tretë për shqyrtimin dhe implementimin e rekomandimeve të zyrës së auditorit gjeneral për vitin 2014 do të përfundoj me 31 janar 2016.

Nr.	Rekomandimi ose gjetja	Veprimi i ndërmarrë ose propozuar	Afati i zbatimit	Statusi
1	**Rekomandimi 1 – Prioriteti i lartë** – Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë që plani për hartimin e PVF të vitit 2015 të adresojë formalisht të gjitha kërkesat e pajtueshmërisë për raportimin financiar. Plani i hartimit të PVF për 2015 të përfshijë rishikimin e draft llogarisë nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, kur draft pasqyrat dorëzohen në Qeveri, të nënshkruhet vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës nga ana e menaxhmentit në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e PVF-ve.	-Verifikimi, se totali i bilanceve të PVF, janë të plota dhe të sakta; -Verifikimin se vlera e pasurive jofinanciare është e plotë dhe zhvlerësimet e tyre janë bërë për të prezentuar vlerën neto në PVF; -Diskutimi i të gjitha paqartësive eventuale Brenda menaxhmentit dhe me akterët e jashtëm ,për të siguruar se përmbajtja dhe saktësia e PVF është e plotë dhe e saktë.	1–31.01.2016	-Është rekomandim i cili pritet të zbatohet pas përfundimit të pasqyrave vjetore financiare për vitin 2015 që dorëzohen deri me 31/01/2016

2	**Rekomandimi 2 – Prioritet i lartë –** Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se kërkesat tjera ligjore të raportimit financiar dhe operativ përmbushen në formatin, përmbajtjen dhe kohën e duhur.	-Heqjen nga plani final i prokurimit të aktiviteteve të prokurimit të zhvilluara në vitet paraprake si kontrata kornizë e që nuk do të zhvillohen në vitin 2015. -Dorëzimi i listës së obligimeve mujore në MF. -Deklarimi ne ATK të listës së blerjeve mbi 500 euro	Me planin vjetor të prokurimit 2016 Çdo 15 të muajt vijues për muajin paraprak. 31.03.2016	-Ky rekomandim zbatohet me dorëzimin e planit final të prokurimit për vitin 2016 në fillim të janarit -Dëshmimi I zyrës së financave me raportet mujore të dorëzuara të obligimeve Kjo pjesë është obligim ligjor për tu kryer në vitin 2016 , me 31.03
3	**Rekomandimi 3** Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë qartazi veprimet praktike dhe afatet kohore për adresimin e rekomandimeve, përfshirë stafin përgjegjës të identifikuar, dhe me fokus fillestar në fushat me mangësi të theksuara.	-Miratimi i planit të zbatimit të rekomandimeve të AGJ; -Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve;	Vlerësimi i parë për zbatimin e rekomandimeve të AGJ me 30.09.2015; Vlerësimi i dytë i zbatimit të rekomandimeve më 30.11.2015; Vlerësimi i tretë 31.03.2016	Vlerësimi I secilit bartës për fushen e vet për rekomandimet e vitit paraprak

4	**Rekomandimi 4.** Kryetarja e KQZ-së duhet ta bëjë një rishikim të rregullimeve ekzistuese të delegimit të përgjegjësive dhe llogaridhënies. Detyrat dhe funksionet kontradiktore të ndahen në pajtim me praktikat, kërkesat dhe rregullativën në fuqi.	-Heqja nga pozita e menaxherit të kontratës, të gjithë zyrtarëve të cilët janë hartues të specifikave teknike	Në zbatim	-Vlerësim i kryeshefit dhe Drejtoreshës së DAP-it
5	**Rekomandimi 5.** Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë që planit buxhetor ti paraprijë një proces rigoroz i vlerësimit që pasqyron plotësisht të gjithë informacionin e duhur duke përfshirë rezultatet e vitit paraprak.	- analiza e planit gjashtë mujor të buxhetit dhe krahasimi me shpenzimet e buxhetit për të njëjtën periudhë;	31.08.2015	-Vlerësim i secilit nga drejtorët se prioritetet e punës së tyre janë në pajtim me politikat buxhetore
6	**Rekomandimi 6** Kryetarja e KQZ-së duhet të bëjë një shqyrtim të dështimit të kontrolleve të brendshme në këtë drejtim dhe të ndërmarrë masa dhe veprime përmirësuese të menjëhershme. Aktivitetet e prokurimit planifikohen të fillojnë në kohën e duhur me qëllim shmangien e aplikimit të PNPNjK-së. Edhe nëse rrethanat e arsyetojnë përdorimin e kësaj procedure, KQZ duhet ketë rol aktiv dhe objektiv në përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe zhvillimin e negociatave, duke mos pasur për qëllim diskriminimin kundër apo në të mirë të ndonjë OE.	-Zbatimi i procedurave të hapura të prokurimit publik, përveç në rastet urgjente; - kontratat që lidhen me furnizime dhe shërbime, për procese zgjedhore të rregullta të aplikohen kontratat kornizë deri në 36 muaj.	Menjëherë	-Nuk ka pasur aktivitet të prokurimit me procedurë të negociuar për vitin 2015. Kërkesa e rekomandimit është roli aktiv dhe objektiv I KQZ-së në negociata me OE
7	**Rekomandimi 7 .**Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se bëhet shqyrtimi i kontrolleve ekzistuese	-Përcaktimi I sasive të planifikuara me planin e	01.08.2015	-Vlerësimi dhe vërtetimi I prokurimit

	në këtë fushë. Në rastet e aplikimit të kontratave publike kornizë, të pasqyrohet konsumi i paraparë apo sasia që pritet të liferohet. Sasia e parashikuar të kalkulohet në bazë të konsumit të ditur dhe të korrigjuar për variacione të pritura.	kërkesave për furnizim apo për ofrim të shërbimit; -Eliminimi I rasteve të përzgjedhjes së OE për një njësi, pa u përcaktuar edhe sasia, sepse përcaktimi I ofertave fituese në bazë të një njësie të vetme pa u përcjellë me sasinë e planifikuar nuk pasqyron saktë se cila ofertë është më e favorshme.		se në aktivitetet e reja të prokurimit të janë kërkuar edhe sasitë që pritet të liferohen
8	**Rekomandimi 8.** Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se përmbushja e kontratave bëhet konform kushteve të përcaktuara. Menaxherët e kontratave duhet të sigurojnë se vlera dhe sasia e furnizimeve ose shërbimeve nuk tejkalon shumat e kontraktuara.	-Azhurnimi i raporteve të kontratave të prokurimit për secilin furnizim apo shërbim të ri të porositur; -Në fund të vitit nga menaxheri I kontratës të behet raporti përfundimtar për zbatimin e kontratës për tërë vitin dhe të bëhen barazimet e menaxherit të kontratës dhe zyrtarëve të logjistikës e të financave.	15.01.2016	-Është rekomandim që pritet të vlerësohet në vitin 2016
9	**Rekomandimi 9 .**Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se do të bëhet një rishikim i rasteve në të cilat procedurat dhe kontrollet nuk janë aplikuar në mënyrë efektive. Veprimet dhe proceset e duhura	-Të respektohen në mënyrë strikte kërkesat për përshtatshmëri, të mos shpërblehen OE që nuk dëshmojnë përshtatshmëri me kërkesat e tenderit;	Në zbatim	-Vlerësimi I prokurimit se kërkesat për përshtatshmëri janë zbatuar, nuk ka pasur kontrata të lidhura pa

	duhet të ndërmerren për të siguruar evitimin e dobësive të tilla në të ardhmen.	-Të mos lidhet asnjë kontratë pa siguruar që ekziston zotimi I plotë I fondeve; -Menaxhimi I kontratë të bëhet sipas ligjit të prokurimit dhe udhëzuesit operativ,		disponim fondesh(ZOTIM) dhe kontratat menaxhohen sipas udhëzuesit operativ
10	**Rekomandimi 10.** Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë që procedurat dhe kërkesat ligjore zbatohen gjatë gjithë kohës duke filluar që nga procesi planifikimit të nevojave dhe zotimit të mjeteve e deri te monitorimi i implementimit të kontratave.	-Kërkesat të planifikohen me kohë dhe të jenë pjesë e planifikimeve buxhetore; -Të gjitha zotimet të bëhen me kohë dhe në lartësinë e planifikuar; -Të sigurohet një shkallë më e lartë e monitorimit të zbatimit të kontratave.	Nga aktiviteti i parë pas raportit të AGJ deri më 30.11.2015.	-Vlerësimit e DAP-it se kërkesat për furnizime dhe shërbime bëhen me kohë, zotimet bëhen me kohë dhe në lartësinë e duhur. -Vlerësimi i prokurimit se monitorimi i zbatimit të kontratave të bëhet në shkallen e duhur
11	**Rekomandimi 11** Kryetarja e KQZ-së duhet të ndërmerr veprimet e duhura që shërbimet e telefonisë mobile të trajtohen konform kërkesave dhe normave ligjore të prokurimit publik, duke siguruar në këtë mënyrë shërbime më cilësore dhe më ekonomike.	-Zbatimi I procedurave të prokurimit edhe për shërbimet e telefonisë mobile	Është lidhur marrëveshja me PTK-në	-Vlerësimi I prokurimit dhe DTI se sherbimet e telefonisë ofrohen dhe trajtohen conform kerkesave dhe normave ligjore të prokurimit publik

12	**Rekomandimi 12 .**Kryetarja e KQZ-së duhet të ndërmerr veprime konkrete dhe të siguroj se është implementuar udhëzimi përkatës por edhe politikat e brendshme të KQZ-së që rregullojnë trajtimin e rasteve të tejkalimit të limitit të shpenzimeve. Në rastet kur ato janë të pa arsyetuara të konsiderohet mundësia për rikthimin e tyre.	-Eleminimi I tejkalimeve të shpenzimeve në raport me planifikimet për të gjitha kategorit e shpenzimeve	Udhëzimi në procedim, pritet miratimi nga KQZ në shtator 2015	Vlerësimi I DAP –it se a ka raste të tejkalimit të të shpenzimeve mbi planin dhe a ka zotime më shumë se sa plani.
13	**Rekomandimi 13 .**Kryetarja e KQZ-së duhet të bëjë një shqyrtim të kontrolleve të brendshme në këtë drejtim. Kompenzimet shtesë të realizohen vetëm pasi të sigurohet se të gjitha procedurat e kalkulimit dhe aktivitetet e ndërmarra janë në përputhje me kornizën aktuale ligjore. 5	-Për të gjitha kompenzimet shtesë të mirren vendime në bazë të ligjeve në fuqi për pagat; -Të sigurohet dokumentacion mbështetës për kompenzimet shtesë; -I terë dokumentacioni për kompenzime shtesë paraprakisht të jetë I aprovuar nga përsonat e autorizuar	01.08.2014	DAP-i të vlerësoj se a ka pasur raste të pagesës së kompenzimeve shtesë dhe a janë bërë në bazë të kornizës ligjore.
14	**Rekomandimi 14** Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se bëhet një zgjedhje e qëndrueshme dhe në përputhshmëri me normat ligjore për pozitat e mbajtura nga ushtrues detyre.	-Shplallja e konkursit për të gjitha pozitat me ushtrues detyre	Shtator 2015	-Vlerësimi I kryeshefit ekzekutiv dhe DAP-it për rregullimin e pozitave me ushtrues detyre
15	**Rekomandimi 15.** Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se të punësuarit me marrëveshje për shërbime të veçanta angazhohen bazuar në	-Analiza e angazhimeve të stafit jopermanent në zgjedhjet paraprake;	Gjatë proceseve të ardhshme zgjedhore	Mbetet rekomandim për tu zbatuar kur të

	vlerësim të mirëfilltë të nevojave për staf për përmbushjen e detyrave shtesë.	-Shqyrtimi dhe rivlerësimi I hollësishëm I nevojave për angazhim të stafit jopermanent për zgjedhjet e ardhshme.		paraqiten nevojat për staf jopermanent.
16	**Rekomandimi 16** Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se të gjitha procedurat dhe kërkesat e përcaktuara me Rr. MF nr. 02/2013 aplikohen në rastet e regjistrimit dhe menaxhimit të pasurisë. Procesi i tillë duhet të përfundojë në kohë të përshtatshme para përgatitjes së PVF të vitit 2015. .	-Regjisrimi I ë gjitha pasurive dhe kodifikimi I tyre; -Përmirësimi I administrimit të pasurive jofinanciare,identifikimi I vendndodhjes së tyre,krijimi I dokumentacionit për levizjen e pasurive dhe informatave kthyese .	Tani e tutje	Është rekomandim që do të vlerësohet në vlerësimin e dytë
17	**Rekomandimi 17** Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se shfrytëzuesit e veturave zyrtare respektojnë dhe zbatojnë të gjitha procedurat dhe kërkesat të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi.	-Respektimi I rregullores për menaxhimin e pasurive jofinanciare; -Respektimi I udhëzimeve administratitve të MAP-it për shfrytëzimin e veturave zyrtare; -Respektimi I rregullores së KQZ-së për përdorimin e veturave zyrtare; -Plotësimi I autorizimeve për përdorimin e automjeteve zyrtare;	01.08.2015	-Vlerësimi I DAP-it,logjistikes se pasurit jofinanciare menaxhohen sipas kornizes ligjore

		-Plotësimi I fletudhëtimeve zyrtare për secilin automjet dhe secilin udhëtim		
18	**Rekomandimi 18.** Kryetarja e KQZ-së duhet të siguroj se obligimet ndaj furnitorëve paguhen brenda 30 ditëve nga pranimi i faturës. Nëse për çfarëdo arsye detyrimet ngelin të papaguara, ato duhet të raportohen brenda afatit mujor në MF/Thesar.	-Të gjitha faturat e pranuara të paguhen Brenda afatit ligjor prej 30 ditësh; -Nëse për arsye objektivë nuk mund të procedohen për pagesë, të gjitha obligimet edhe ato të cilave u ka kaluar afati i pagesës edhe ato të cilat kana fat pagese, në baza mujore sipas rregullës financiare 02/2011,të deklarohen ne MF	01.08.2015	Vlerësimi dhe vërtetimi nga DAP,se të gjitha faturat paguhen Brenda afatit 30 ditor,dhe nuk ka obligime të bartura në muajt vijues
19	**Rekomandimi 19.** Kryetarja e KQZ-së duhet të sigurojë se Komiteti i Auditimit funksionon dhe vepron në përputhje me detyrat dhe përgjegjësit ligjore.	-Funksionalizimi I KA	Është funksionalizuar	Vlerësimi I komitetit të auditimit se KA është funksionalizuar

8 Shtojcat

1. Shtojca 1 - Plani i Punës se KQZ-së për vitin 2015
2. Shtojca 2 – Plani Strategjik i KQZ-së 2015-2018
3. Shtojca 3 - Organograni i KQZ-së
4. Shtojca 4 – Raporti Financiar

Plani vjetor i punës

Plani vjetor i punës se KQZ-së përgatitet çdo vit, në bazë të rezultateve të synuara, strategjisë, buxhetit dhe partnerëve implementues të identifikuar, duke pasqyruar arritjet dhe mësimet e mësuara te vitit paraprak.

Plani Vjetor i Punës për vitin 2015 ofron planifikim të detajuar të aktivitetit dhe përcakton se çfarë do të realizohet gjatë vitit për çdo projekt të identifikuar. PVP përmban: objektivat, rezultatet e pritura, aktivitetet që do të kryhen në drejtim të arritjes së rezultateve të pritshme; korniza kohore për ndërmarrjen e aktiviteteve të planifikuara; përgjegjësit për kryerjen e aktiviteteve, mbikëqyrësit e implementimit te aktiviteteve, dhe kostoja .

I. **OBJEKTIVI - OPERACIONET ZGJEDHORE**								
REZULTATET: OPERACIONE ZGJEDHORE TE PLANIFIKUARA MIRE, THJESHTIMI I PROCEDURAVE ZGJEDHORE, KRIJIMI I KUSHTEVE ME TE MIRA PËR VOTUESIT.								
NR.	AKTIVITETET E PLANIFIKUARA	AFATI KOHOR				PËRGJEGJËS	MBIKËQYRJA	KOSTOJA FINANCIARE
		T1	T2	T3	T4			
1.1	Hartimi i plani operacional për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Graçanicë 2015	X				DOZ/SKQZ	KOZ/KQZ	PA KOSTO
1.2	Hartimi i buxhetit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Graçanicë 2015	X				DAP/SKQZ	DAP/KQZ	PA KOSTO
1.3	Bashkëpunimi me Prokurorinë e shtetit për shkatërrimin e materialit zgjedhor të akumuluar	X	X	X		DÇL,QNR/SKQZ	KOZ/KQZ	PA KOSTO
1.4	Shkatërrimi i materialit te zgjedhjeve	X				DÇL,DAP/SKQZ	KOZ/KQZ	----------
1.5	Analizimi (rishikimi) i doracakut te trajnimit	X	X			DOZ/SKQZ	KOZ/KQZ	PA KOSTO
1.6	Formulari për vazhdimin e regjistrimit te Partive Politike	X				ZRPP	KPP/KQZ	PA KOSTO
1.7	Shqyrtimi dhe vlerësimi i funksioneve të QNR-së në përputhje më praktikat ndërkombëtare	X	X			QNR/SKQZ	KOZ/QNR	PA KOSTO
1.9	Paraqitja hartografike të qendrave të votimit që kanë qasje për personat me aftësi të Kufizuara dhe me të gjitha specifikat tjera.	X				DOZ,DTI,KT,SKQZ	KOZ/KQZ	DONACION / IFES

1.10	Krijimi për nevoja të brendshme i një "harte" pasqyre gjeografike për ecurinë e zgjedhjeve (kutitë e rinumëruara, ankesat, votat e dyfishta etj)		X			QNR,KT,DOZ/SKQZ	KOZ/KQZ	PA KOSTO

II. **Objektivi - EDUKIMI DHE INFORMIMI I VOTUESVE**								
REZULTATET - Informim i votuesve për të drejtat zgjedhore dhe motivimi për rëndësinë e realizimit te tyre, informimi me i mire për procedurat dhe mënyrën e votimit, komunikim i përhershëm me publikun.								
	AKTIVITETET E PLANIFIKUARA	AFATI KOHOR				PËRGJEGJËS	MBIKËQYRJA	KOSTOJA FINANCIARE
		T1	T2	T3	T4			
2.1	Shqyrtimi i strategjisë për Informimin Publik		X			DOZ,SKQZ	KOZ/KQZ	PA KOSTO
2.2	Hartimi i dosjes se informimit publik		X			ZRPP	KQZ	PA KOSTO
2.3	Edukimi dhe informimi i votuesve te rinjë		X	X		DOZ/SKQZ	KQZ	Rishikim /Donator

III. **Objektivi - FUQIZIMI INSTITUCIONAL**								
REZULTATET - Strukturë organizative në pajtim me qëllimet e KQZ-së , qëndrueshmëri financiare, kornizë rregullative për funksionimin e brendshëm, stafi plotësisht i trajnuar dhe profesional, trupa zgjedhore (KKZ dhe KVV) kompetente dhe efektive.								
	AKTIVITETET E PLANIFIKUARA	AFATI KOHOR				PËRGJEGJËS	MBIKËQYRJA	KOSTOJA FINANCIARE
		T1	T2	T3	T4			

3.1	Takim pune me zyrtarët komunal për prezantimin e planit të punës	X				KT/SKQZ	KOZ,KQZ	----------
3.2	Raportimi i Pasqyrave financiare te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve për vitin 2014	X				DAP/SKQZ	KBP/KQZ	PA KOSTO
3.3	Raporti dhe vlerësimi i zbatimit të planit te punës te vitit 2015		X			SKQZ	KOZ/KQZ	PA KOSTO
3.4	Hartimi i planit strategjik të KQZ-së për vitin 2015 – 2018	X				KOMISIONI/SKQZ	KOZ/KQZ	PA KOSTO
3.5	Kompletimi dhe funksionalizimi i komitetit te auditimit	X				AUDITORI BRENDSHEM /SKQZ	KQZ	PA KOSTO
3.6	Implementimi i Planit të Prokurimit për vitin 2015	X	X	X	X	PROKURIMI /SKQZ	KBP,KQZP	PA KOSTO
3.7	Korniza afatmesme e shpenzimeve 2016 -2018		X			DAP/SKQZ	KBP,KQZ	PA KOSTO
3.8	Hartimi i planit te punës te KQZ-se për vitin 2016				X	SKQZ	KOZ/KQZ	----------
3.9	Hartimi i planit te buxhetit për vitin 2016 - 2018		X			DAP/SKQZ	KBP/KQZ	PA KOSTO
3.10	Hartimi i planit preliminar te prokurimit për vitin 2016				X	PROKURIMI/SKQZ	KBP/SKQZ	PA KOSTO
3.11	Shqyrtimi i implementimit te rekomandimeve te zyrës se auditorit gjeneral te vitit 2014			X	X	AUDITORI BRENDSHEM /SKQZ	KBP/KQZ	PA KOSTO

3.12	Miratimi i Planit te Auditimit për 2015	X				AUDITORI BRENDSHEM /SKQZ	KOMITETI I AUDITIMIT/KQZ	PA KOSTO
3.13	Rishikimi eventual implementimin e Planit te Punës për vitin 2015		X			SKQZ	KOZ/KQZ	PA KOSTO
3.14	Rishikimi i Buxhetit dhe Planit te Prokurimit te KQZ-së për vitin 2015		X			DAP,PROKURIMI / SKQZ	KBP/KQZ	PA KOSTO
3.15	Shqyrtimi dhe Aprovimi i Raporteve te Auditimit		X	X	X	AUDITORI BRENDSHEM /SKQZ	KOMITETI I AUDITIMIT/KQZ	PA KOSTO
3.16	Raportet e Auditimit – Publikimet		X			ZRPP	KQZ	----------
3.18	Trajnime te vazhdueshme profesionale te stafit te SKQZ-së	X	X	X	X	SKQZ	KQZ	20,000.00 €
3.19	Vëzhgimi i Zgjedhjeve në Shtetet e Rajonit	X	X	X	X	SKQZ	KQZ	----------
3.20	Trajnimi dhe certifikimi deri në tre përfaqësues të subjekteve politike për secilën komunë për detyrat dhe përgjegjësitë e KKZ-së		X	X	X	DÇL,DOZ	KOZ,KQZ	----------
3.21	Sigurimi i hapësirave te punës (zyrat, depo dhe arkivë)	X	X	X		SKQZ	KQZ	----------
3.22	Analizimi i strukturës organizative ne pajtim me qëllimet e KQZ-së		X	X		SKQZ	KQZ	PA KOSTO
3.23	Procedure dhe udhëzues për funksionim e brendshëm		X			DÇL/SKQZ	KQZ	PA KOSTO

3.24	Përkthimi dhe publikimi i librave/publikimeve			x		DOZ,DAP/SKQZ	KOZ/KQZ	

IV. Objektivi - LISTA E VOTUESVE

Rezultatet . Lista e votuesve e saktë dhe gjithëpërfshirëse

	AKTIVITETET E PLANIFIKUARA	AFATI KOHOR				PËRGJEGJËS	MBIKËQYRJA	KOSTOJA FINANCIARE
		T1	T2	T3	T4			
4.1	Ri funksionalizimi i grupeve punuese KQZ-MPB për përmirësimin e LV-së	X	X	X	X	DOZ/SKQZ	Grupi Punues për LV, KQZ	PA KOSTO
4.2	Përmirësimi dhe qëndrueshmëria e Listës së Votuesve ” Vendbanimi im Vendvotimi im”		X	X	X	DOZ/SKQZ	Grupi Punues për LV, KQZ	RISHIKIMI/ DONATOR

V. Objektivi - PJESËMARRJA NË ZGJEDHJE

Rezultatet 5. Pjesëmarrje më e lartë e votuesve në zgjedhje

	AKTIVITETET E PLANIFIKUARA	AFATI KOHOR				PËRGJEGJËS	MBIKËQYRJA	KOSTOJA FINANCIARE
		T1	T2	T3	T4			
5.1	Publikimi i raportit statistikore për trendët zgjedhore 2000 – 2014	X				SKQZ	KOZ,KQZ	500 Euro
5.2	Konferencë ku prezantohen trendët zgjedhore		X			SKQZ	KOZ,KQZ	PA KOSTO

VI. **Objektivi - INOVACIONI DHE TEKNOLOGJIA**								
Rezultatet . Rritje e përdorimit të teknologjisë në operacione zgjedhore , ngritje e njohurive në aplikimin e teknologjisë në zgjedhje								
	AKTIVITETET E PLANIFIKUARA	AFATI KOHOR				PËRGJEGJËS	MBIKËQYRJA	KOSTOJA FINANCIARE
		T1	T2	T3	T4			
6.1	Platforma për modernizimin e operacioneve zgjedhore.	X	X	X	X	DTI/SKQZ	KOZ/KQZ	RISHIKIMI/ DONATOR
6.2	Hulumtim dhe studim fizibiliteti për përdorimin e teknologjisë ne zgjedhje		X	X	X	DTI,QNR,DOZ /SKQZ	KOZ/KQZ	PA KOSTO
6.3	Skanimi i formularëve te rezultateve		X	X		QNR,DTI/SKQZ	KOZ/KQZ	RISHIKIMI/ DONATOR
6.4	Regjistrimi dhe evidentimi i materialit zgjedhor		X	X		QNR ,DTI/SKQZ	KOZ/KQZ	RISHIKIMI/ DONATOR
6.5	Analizimi i strukturës dhe përmbajtjes se ueb faqes se KQZ-së	X	X			DTI/SKQZ ZEDHENSI	KOZ/KQZ	PA KOSTO

VII. **Objektivi - BASHKËPUNIMI ME AKTERËT E JASHTËM**								
Rezultati 7. Partneritet më i mirë me subjektet politike, shoqërinë civile dhe, bashkëpunim i zgjeruar strategjik me organizatat ndërkombëtare dhe donatorët, promovim më i mirë ndërkombëtar i KQZ-së.								
	AKTIVITETET E PLANIFIKUARA	AFATI KOHOR				PËRGJEGJËS	MBIKËQYRJA	KOSTOJA FINANCIARE
		T1	T2	T3	T4			
7.1	Dita e KQZ-së Republikës se Kosovës – 18 Prill	X	X			SKQZ	KPM,KOZ /KQZ	----------

7.2	Raporti për Kuvendin e Republikës së Kosovës	X	X			SKQZ	KOZ/KQZ	PA KOSTO
7.3	Raportimi i progresit nga KQZ-ja për Planin e Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit	X	X	X	X	DÇL,SKQZ	KOZ/KQZ	PA KOSTO
7.4	Raporti vjetor për Kuvendin e Kosovës për shpërndarjen dhe shpenzimin e mjeteve nga fondi për financimin e subjekteve politike		X			DAP	KQZ	PA KOSTO
7.5	Shënimi i ditës globale te zgjedhjeve	X				DOZ,SKQZ	KOZ/KQZ	----------
7.6	Nxjerrja e një fletushke elektronike për aktivitet tre mujore dhe shpërndarja tek subjektet politike dhe OJQ-të dhe akterët tjerë.		X		X	ZEDHENSI, DOZ,SKQZ	KOZ/KQZ	
7.7	Raporti i shpenzimeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune Graçanicë	x				DAP,SKQZ	KBP/KQZ	PA KOSTO
7.8	Azhurnimi vjetor i te dhënave te Subjekteve Politike	X				ZRPP	KQZ	PA KOSTO
7.9	Takimet e rregullta me Subjektet politike	X	X	X	X	ZRPP	KQZ	PA KOSTO
7.10	Raportet Vjetore te SP-ve	X				ZRPP	KQZ	PA KOSTO
7.11	Monitorimi i Kuvendeve Zgjedhore	X	X	X	X	ZRPP	KQZ	PA KOSTO
7.12	Informimi për Monitorimin e Kuvendeve Zgjedhore		X		X	ZRPP	KQZ	
7.13	Regjistrimi i Subjekteve Politike	X	X	X	X	ZRPP	KQZ	PA KOSTO
7.14	Pjesëmarrje ne Konferencën vjetore te ACEEEO		X	X		SKQZ	KQZ	

7.15	Identifikimi dhe pjesëmarrja ne aktivitete (trajnime, konferenca etj) qe merren me fushën e zgjedhjeve	X	X	X	X	SKQZ	KOZ,KMJ/KQZ	
7.16	Thellimi i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare me qellim te financimi te projekteve te KQZ	X	X	X	X	SKQZ	KQZ	PA KOSTO
7.17	Konferenca rajonale me TMZ me temën "Pjesëmarrja e personave me aftësi te kufizuara"				X	SKQZ	KMJ/KQZ	----------
7.18	Konferenca e nivelit kombëtare me institucionet shtetërore te Republikës se Kosovës		X			SKQZ	KMJ/KQZ	----------
7.19	Marrëveshje për bashkëpunimi me KQZ-në Turqisë, Bullgarisë, Meksikës dhe Kanadasë.	X	X			SKQZ	KMJ/KQZ	PA KOSTO
7.20	Punëtori e përbashkët ne mes KQZ Kosovë dhe KQZ Shqipëri për përvojat ne zgjedhje.			X		SKQZ	KMJ,KOZ/KQZ	----------

VIII.	**Objektivi - KORNIZA LIGJORE**							
Rezultati 8. Kornizë nënligjore në përputhje me ligjet e vendit dhe standardet ndërkombëtare , të qenit akter në procesin e reformës zgjedhore								
	AKTIVITETET E PLANIFIKUARA	AFATI KOHOR				PËRGJEGJËS	MBIKËQYRJA	KOSTOJA FINANCIARE
		T1	T2	T3	T4			
8.1	Ndryshim dhe plotësimi i rregullores se punës te KQZ-se	X				DÇL,SKQZ	KP/SKQZ	PA KOSTO

8.2	Shqyrtimi dhe plotësimi i Rregullores se Punës së SKQZ-së	X				DÇL,SKQZ	KP/SKQZ	PA KOSTO
8.3	Hartimi i udhëzuesit për menaxher dhe stafin teknik te Qendrave te Votimit		X			KT,DÇL,SKQZ	KPP,KOZ/KQZ	PA KOSTO
8.4	Rishikimi i Rregullave te KQZ-së			X		DÇL,ZRPP	KPP/KQZ	PA KOSTO
8.5	Hartimi i rregullës se punës te KKZ-së			X		DÇL,SKQZ	KPP/KQZ	PA KOSTO
8.6	Hartimi i rregullores se KVV-ve			X		DÇL,SKQZ	KPP/KQZ	PA KOSTO
8.7	Udhëzimi administrativ për arkivimin dhe ruajtjen e lendeve arkivore		X			DÇL,DAP/SKQZ	KPP/KQZ	PA KOSTO
8.8	Rishikimi i udhëzimeve : 1) UA nr. 01/2010 mbi caktimin e shpenzimeve të reprezentacionit për anëtarët e KQZ-së 2) UA nr. 02/2010 mbi shfrytëzimin e automjeteve të Sekretariatit të KQZ-së 3) UA nr. 03/2010 mbi shfrytëzimin e linjës fikse dhe telefonave mobilë zyrtarë, dhe SIM kartelës nga anëtarët e KQZ-së dhe zyrtarët e SKQZ-së		X			DÇL,SKQZ	KPP,KBP/KQZ	PA KOSTO

Vizioni

Për një institucion të qëndrueshëm dhe inovativ, që forcon demokracinë përmes zgjedhjeve, të cilat gëzojnë besimin e qytetarëve dhe të akterëve të tjerë.

Misioni

Ne jemi të përkushtuar të organizojmë zgjedhje kredibile dhe me standarde të larta, duke u ofruar të gjithë qytetarëve mundësi dhe shërbime cilësore zgjedhore për ushtrimin e së drejtës së tyre për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

Parimet orientuese

Parimet mbi të cilat mbështetet puna e KQZ-së janë :

Ligjshmëria: Përmbushim funksionet dhe të gjitha aktivitetet tona në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore.

Pavarësia dhe paanshmëria: Ushtrojmë përgjegjësitë tona në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.

Transparenca dhe llogaridhënia: Jemi të hapur dhe llogaridhënës në veprimet e tona dhe sigurojmë qasje në informata relevante për të gjitha palët.

Profesionalizmi dhe përkushtimi: Angazhohemi që në mënyrë efikase të ofrojmë shërbime cilësore në bazë të standardeve më të larta.

Gjithëpërfshirja dhe barazia: Ofrojmë kushte dhe mundësi të barabarta për pjesëmarrjen e të gjitha grupeve në zgjedhje.

Inovacioni dhe përmirësimi i vazhdueshëm: Rishikojmë në mënyrë të vazhdueshme sistemin e punës dhe praktikat në mënyrë që të jenë në hap me kohën duke aplikuar metoda inovative.

Integriteti dhe kredibiliteti: Angazhohemi për besueshmëri dhe pranueshmëri të publikut në zgjedhje dhe në procesin demokratik në përgjithësi.

Korniza Strategjike

Sipas metodologjisë në të cilën është bazuar hartimi i kësaj strategjie, komponentët kryesorë të strategjisë së KQZ-së janë: shtyllat strategjike, synimet strategjike, veprimet strategjike, objektivat strategjike, aktivitetet strategjike dhe indikatorët e matshëm. Shtyllat strategjike të KQZ-së janë sfera kyçe strategjike me përmbushjen e të cilave do të mundësohet realizimi i strategjisë së

përgjithshme të organizatës. Strategjia e KQZ-së përbehet nga 8 shtylla strategjike, me përmbushjen e të cilave do të mundësohet realizimi i strategjisë së përgjithshme të KQZ-së.

Secila shtyllë strategjike e ka të paktën një synim strategjik dhe secili synim ka një apo më shumë veprime strategjike që realizohen përmes aktiviteteve strategjike si pjesë e objektivave konkrete strategjike. KQZ-ja ka identifikuar shtyllat kryesore strategjike si në vijim:

1) Operacionet zgjedhore- me synimin që aktivitetet zgjedhore të planifikohen me saktësi, të ketë procedura të thjeshtëzuara, votimi të jetë plotësisht i qasshëm, dhe të ketë rezultate që janë të sakta dhe të shpejta;

2) Edukimi dhe informimi i votuesve – me synimin që votuesit të jenë të informuar për të drejtat zgjedhore dhe të motivuar për rëndësinë e realizimit të tyre, të ketë komunikim të përhershëm me publikun në format të qasshëm, dhe që votuesit të jenë të informuar për procedurat dhe mënyrën e votimit;

